



UNIVERSITETI I EJL
ЈНЕ УНИБЕРЗИТЕТ
SEE UNIVERSITY

PUNIM MAGJISTRATURE

STUDIME POSTDIPLOMIKE

FAKULTETI JURIDIK-UEJL

DREJTIMI-JURIDIK

**TEMA: “POZITA JURDIKE-PENALE E FËMIJËVE SIPAS LIGJIT TË RI PËR FËMIJËT NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË”**

Mentori: prof. dr. Ismail Zejneli

Kandidati: Sadije Haliti

Tetovë, 2020

Teza e magistraturës:

“ Pozita juridike - penale e fëmijëve sipas ligjit të ri për fëmijë në Republikën e Maqedonisë ”

Përkthimi i titullit punues në maqedonisht:

“Правната положба на децата според новиот законик за правда за деца во Република Македонија”

Përkthimi i titullit punues në anglisht:

“Legal-criminal status of children according to new law for childrens in the Republic of Macedonia”

Përmbajtja

1. Lënda e Hulumtimit

- 1.1.**Nocioni, kuptimi i të Drejtave të Fëmijëve sipas legjislacioneve nacionale
- 1.2.**Zhvillimi historik i Të Drejtave të Fëmijëve
- 1.3.**Mbrojtja ligjore e Të Drejtave të Fëmijëve sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë
- 1.4.**Mbrojtja ligjore sipas Ligjit të Punës dhe Kodit Penal të RM-së
- 1.5.**Mbrojtja ligjore sipas Kartës Sociale Europiane (e rishikuar)

KAPITULLI I II-të

- 2.1.**Dhuna ndaj fëmijëve nëpër shkolla në Maqedoni
- 2.2.**Mbrojtja e të drejtave të Fëmijëve sipas Konventës për të Drejtat e fëmijës
- 2.3.**Konventa europiane për të drejtat e fëmijëve “Për Marrëdhëniet me fëmijët” dhe “Mbi ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve”
- 2.4.**Dita ndërkombëtare e Të Drejtave të Fëmijëve
- 2.5.**Organizatat për të drejtat e Fëmijëve që veprojnë në Maqedoni (Unicef, Save the Children dhe të tjera)

KAPITULLI I III-të

- 3.1.**Roli i ligjit të ri për të miturit
- 3.2.**Përparësitë dhe mangësitë në krahasim me ligjin paraprak për fëmijë në RM
- 3.3.**Iniciativat e OJQ-ve të tjera mbi mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Maqedoni.

KAPITULLI I IV-të

- 4.1.**Avokati i Popullit si mbrojtës i të Drejtave të Fëmijëve
- 4.2.**Shkeljet e të drejtave të fëmijëve në Maqedoni

2. Rekomandimet dhe Konkluzionet

1. Lënda e Hulumtimit

Lëndë e Hulumtimit në këtë punim shkencor është statusi juridiko-penal i fëmijëve sipas ligjit të ri për fëmijët në Republikën e Maqedonisë. Të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtja sa më e efikase e tyre dhe luftimi i shkeljes së të drejtave të fëmijëve janë prioritete që çdo shtet i lirë dhe demokratik ia paracakton vetes dhe Republika e Maqedonisë këtu nuk bën përjashtim. Sjellja në fuqi e ligjit të ri për fëmijët është vetëm një dëshmi më tepër për këtë.

Kjo tezë e magjistraturës i kushtohet në përgjithësi pozitës juridiko-penal të fëmijëve e cila parasheh Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, për qëllime të këtij hulumtimi kam analizuar edhe zanafillën historike të mbrojtjes së këtyre të drejtave, pastaj mbrojtjen ligjore dhe kam vazhduar me dispozitat kushtetuese të vendit tonë të cilat mbrojnë këtë kategori personash e deri tek Karta Sociale Europiane e cila kujdeset për implementimin e dispozitave gjegjëse edhe në rafshin ndërkombëtar. Në këtë temë poashtu, planifikoj të trajtoj dhunën ndaj fëmijëve nëpër shkolla në Maqedoni si vende ku më së shumti janë të ekspozuar kjo kategori personash dhe rolin që ka ligji i ri në parandalimin e kësaj.

2. Qëllimi i Hulumtimit

Punimi shkencor me titull “Pozita juridike e fëmijëve sipas ligjit të ri për të miturit në Republikën Veriore të Maqedonisë”, ka si synim parësor të nënvizoj pikërisht të drejtat e fëmijëve në territorin e RVM-së respektivisht mbrojtjen e tyre si dhe të sjell para jush statistikat se si respektohen këto të drejta në RVM.

Fëmijët janë e ardhmja dhe bazamenti-shtylla e një vendi dhe nëqoftëse një vend përdor mjetin shtypës dhe jo ligjor ndaj tyre kemi të bëjmë me një shtet jo ligjor.

Për ti parë këto vështrime, suksesin, shkeljet, iniciativat që merren dhe bëhen në Mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Maqedoni, unë kam përzgjedhur të elaboroj një temë të tillë për mbrojtjen e studimeve të magjistraturës.

Pra, qëllimi kryesor dhe eseencial i këtij punimi të magjistraturës janë Fëmijët me epiqendër Të drejtat e tyre në Republikën e Maqedonisë qoftë me mekanizma institucional vendas qoftë me mekanizma ligjore ndër-shtetërore dhe ndërkombëtare.

3. Hipotezat

Gjatë finalizimit të kësaj teme të magjistraturës do të mundohem që të qartësoj dhe të jap një shpjegim të qartë se çka nënkupton pozita apo statusi juridiko-penal i fëmijëve në aspektin ligjor, ndërsa me theks të veçantë rolin dhe rëndësinë e ligjit të ri për mbrojtjen e fëmijëve.

4. Metodologjia e Punimit

Metodologjia e përdorur për përgatitjen e këtij punimi bazohet në një studim të kujdesshëm dhe hulumtim të thellë.

Hulumtimi i kësaj teme është i mbështetur nga të dhëna dhe burime të ndryshme.

Duhet të potencohet se udhëzimet dhe këshillat e mentorit kanë rol të rëndësishëm në përpilimin e këtij punimi.

Materialet dhe literatura e përdorur për punimin e kësaj teme të diplomës kanë për qëllim këndvështrimin dhe analizën e të drejtave të fëmijëve në vendin tonë dhe vështrimin në mbrojtjen e tyre.

Metodat kryesore që janë përdorur për mbledhjen e të dhënave janë;

1. Leximi i literaturës

2. Janë marrë pjesë nga interneti si dhe

Në punimin shkencor me titull: “Pozita juridike e fëmijëve sipas ligjit të ri për të miturit në Republikën e Maqedonisë”, për të ju qasur hulumtimit kam përdorur këto metoda:

3. Metodën dogmatike juridike, duke marrë parasysh se në studimet e thelluara të drejtësisë asnjë punim i mirëfillt shkencor nuk mund të bazohet pa metodën gjegjëse.

4. Metodën empirike apo historike dhe metodën statistikore që u referohen të dhënave të ndryshme të institucioneve relevante dhe OJQ-ve në Republikën e Maqedonisë sa ju përket të drejtave të fëmijëve.

5. Rëndësia e punimit

Punimi shkencor me titull: “Pozita juridike-penale e fëmijëve sipas ligjit të ri për të miturit në Republikën e Maqedonisë”, ka një rëndësi të veçantë, pasi që është një analizë e detajuar e ligjit pra është një punim autentik dhe i llojit të veçantë.

Statusi juridiko-penal i fëmijëve është një temë shumë pak e trajtuar nga studiuesit e shkencave juridike, prandaj ky punim mund të shërbej si referencë edhe për studim më të thellë të kësaj teme në të ardhmen.

Duke pasur parasysh se jetojmë brenda një shoqërie me tipare konzervatore dhe njëkohësisht brenda një shteti i cili shumë pak kujdeset për shtresat fragjile siç janë fëmijët, zbatimi i dispozitave ligjore has në barriera të shumta dhe këto të fundit (fëmijët) janë minimalisht të sensibilizuar me të drejtat që ju takojnë. Në këtë prizëm pres që punimi im të shërbejë për përmirësimin e kësaj klime ekzistuese.

Struktura e punimit:

KAPITULLI I-rë

Ne kapitullin e parë trajtohen këto tema:

- 1.1.Nocioni, kuptimi i Të Drejtave të Fëmijëve sipas legjislacioneve nacionale,
- 1.2.Zhvillimi historik i Të Drejtave të Fëmijëve, Mbrojtja ligjore e Të Drejtave të
- 1.3.Fëmijëve sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, Mbrojtja ligjore sipas
- 1.4.Ligjit të Punës dhe Kodit Penal të RM-së dhe Mbrojtja ligjore sipas Kartës Sociale Europiane (e rishikuar).

KAPITULLI II-të

Ne kapitullin e dytë do të trajtohen këto tema:

- 2.1.Dhuna ndaj fëmijëve nëpër shkolla në Maqedoni
- 2.2.Mbrojtja e të drejtave të Fëmijëve sipas Konventës për të Drejtat e fëmijës
- 2.3.Konventa europiane për të drejtat e fëmijëve “Për Marrëdhëniet me fëmijët” dhe “Mbi ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve”
- 2.4.Dita ndërkombëtare e Të Drejtave të Fëmijëve
- 2.5.Organizatrat për të drejtat e Fëmijëve që veprojnë në Maqedoni (Unicef, Save the Children dhe të tjera.

KAPITULLI III-të

- 3.1.Roli i ligjit të ri për të miturit
- 3.2.Përparësitë dhe mangësitë në krahasim me ligjin paraprak për fëmijë në RM.
- 3.3.Iniciativat e OJQ-ve të tjera mbi mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Maqedoni.

KAPITULLI IV-të

- 4.1.Avokati i Popullit si mbrojtës i të Drejtave të Fëmijëve
- 4.2.Shkeljet e të drejtave të fëmijëve-viktimë në Maqedoni.

Hyrje

Lëndë e Hulumtimit në këtë punim shkencor është pozita e juridike e fëmijëve sipas ligjit të ri për fëmijët në Republikën e Maqedonisë Veriore. Të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtja sa më e efektshme e tyre dhe luftimi i shkeljes së të drejtave të fëmijëve janë prioritete që çdo shtet i lirë dhe demokratik ia paracakton vetes dhe Republika e Maqedonisë këtu nuk bën përjashtim. Sjellja në fuqi e ligjit të ri për fëmijët është vetëm një dëshmi më tepër për këtë.

Kjo tezë e magistraturës i kushtohet në përgjithësi statusit juridiko-penal të fëmijëve i cili parasheh Mbrojtjen së të Drejtave të Fëmijëve. Për qëllime të këtij hulumtimi kam analizuar edhe zanafillën historike të mbrojtjes së këtyre të drejtave, pastaj mbrojtjen ligjore dhe kam vazhduar me dispozitat kushtetuese të vendit tonë të cilat mbrojnë këtë kategori personash e deri tek Karta Sociale Europiane, e cila kujdeset për implementimin e dispozitave gjegjëse edhe në rafshin ndërkombëtar. Në këtë temë poashtu planifikoj të trajtoj dhunën ndaj fëmijëve nëpër shkolla në Maqedoni si vende ku më së shumti janë të ekspozuar kjo kategori personash dhe rolin që ka ligji i ri në parandalimin e kësaj.

Punimi shkencor me titull “Pozita juridike e fëmijëve sipas ligjit të ri për të miturit në Republikën e Maqedonisë Veriore”, ka si synim parësor të nënvizoj pikërisht të drejtat e fëmijëve në territorin e RM-së respektivisht mbrojtjen e tyre si dhe të sjell para jush statistikën se sa respektohen këto të drejta në RMV.

Fëmijët janë e ardhmja dhe bazamenti-shtylla e një vendi dhe nëqoftëse një vend përdor mjetin shtypës dhe jo ligjor ndaj tyre kemi të bëjmë me një shtet jo ligjor.

Për ti parë këto vështrime, suksesin, shkeljet, iniciativat që merren dhe bëhen në Mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Maqedoni unë kam përzgjedhur të elaboroj një temë të tillë për mbrojtjen e studimeve të magistraturës.

Pra, qëllimi kryesor dhe eseencial i këtij punimi janë Fëmijët me epiqendër, Të drejtat e tyre në Republikën e Maqedonisë Veriore, qoftë me mekanizma institucional vendas qoftë me mekanizma ligjore ndër-shtetërore dhe ndërkombëtare.

Gjatë finalizimit të kësaj teme të magjistraturës do të mundohem që të qartësoj dhe të jap një shpjegim të qartë se çka nënkupton pozita apo statusi juridiko-penal i fëmijëve në aspektin ligjor, ndërsa me theks të veçantë rolin dhe risitë e ligjit të ri për mbrojtjen e fëmijëve.

Metodologjia e përdorur për përgatitjen e këtij punimi bazohet në një studim të kujdesshëm dhe hulumtim të thellë.

Hulumtimi i kësaj teme është i mbështetur nga të dhëna dhe burime të ndryshme. Duhet të potencohet se udhëzimet dhe këshillat e mentorit kanë rol të rëndësishëm në përpilimin e këtij punimi. Materialet dhe literatura e përdorur për punimin e kësaj teme të magjistraturës kanë për qëllim këndvështrimin dhe analizën e të drejtave të fëmijëve në vendin tonë dhe vështrimin në mbrojtjen e tyre.

Punimi shkencor me titull: “Pozita juridike e fëmijëve sipas ligjit të ri për të miturit në Republikën e Maqedonisë Veriore“, ka një rëndësi të veçantë, pasi që është një analizë e detajuar e ligjit, pra është një punim autentik dhe i llojit të veçantë.

Pozita apo statusi juridiko-penal i fëmijëve është një temë shumë pak e trajtuar nga studiuesit e shkencave juridike, prandaj ky punim mund të shërbejë si referencë edhe për studim më të thellë të kësaj teme në të ardhmen.

Duke e pasur parasysh se jetojmë brenda një shoqërie me tipare konzervatore dhe njëkohësisht brenda një shteti i cili shumë pak kujdeset për shtresat fragjile siç janë fëmijët, zbatimi i dispozitave ligjore has në barriera të shumta dhe këto të fundit (fëmijët) janë minimalisht të sensibilizuar me të drejtat që ju takojnë. Në këtë prizëm pres që punimi im të shërbejë për përmirësimin e kësaj klime ekzistuese.

KAPITULLI I PARË

1.1. Nocioni, kuptimi i Të Drejtave të Fëmijëve sipas legjislacioneve nacionale

Nëse sot është e pakontestueshme se krimi është problem themelor i shoqërisë moderne dhe cënim më i rëndë i kualitetit të jetës së njeriut, është e pakontestueshme se në fenomenologjinë e tij, delikuenca e të miturve e ka kuptim të shkallës së parë. Bëhet fjalë për sferë të kimit specifik në rradhë të pare për shkak të kryerësve të saj, të të miturve të cilët nuk janë kriminel të vegjël, kurse sjellja e tyre delikuate dhe përgjigja për të nuk mund të krahasohen me konceptet klasike kriminalo-politike dhe konceptet penalo-juridike për çrrënjosjen e kimit të të rriturve.¹

Në literaturën kriminologjike dhe juridiko-penale hasim një numër bukur të madh të përkufizimeve të kuptimit të delikuencës së të miturve. Shikuar më gjërë, gati se nuk ekziston lëmi në të cilën ndeshen kaq shumë kuptime dhe konfuzione terminologjike gjë që tregon se kjo problematikë ka nevojë që në mënyrë shkencore të ndriçohet. Pa një përkufizim të qartë dhe preciz nuk mund në mënyrë shkencore të trajtohet kjo dukuri, pasi që nuk mund të bëhet dallimi me dukuritë tjera. Përkufizimi i qartë terminologjik mundëson shpjegim dhe trajtim praktik të kësaj dukurie, pra të delikuencës së të miturve. Prej të gjitha kuptimeve që i kemi hasur, si në literaturën sociologjike, kriminologjike dhe atë juridike, në kuptimin më të gjërë përdoret nocioni delikuencë e të miturve ose sjellje delikuate e të rinjëve².

- fëmijë është çdo person deri në moshën 18 vjet,

- fëmijë në rrezik çdo fëmijë që i ka mbushur shtatë vjet dhe nuk i ka mbushur 18 vjet me pengesa trupore ose pengesa të zhvillimit mental, viktimë e dhunës, i lënë pas dore nga aspekti edukues dhe social, i cili gjendet në gjendje të atillë në të cilën është penguar ose është pamundësuar realizimi i funksionit edukues i prindit/ëve ose tutorit/ëve, i cili nuk është

¹V.Kambovski, E drejta penale- pjesa e përgjithshme (përkthim), Shkup, 2006, fq.593

² Ismail Zejneli, Delikuenca e të miturve, Tetovë, 2018, fq.13

përfshirë në sistemin e arsimit dhe edukimit, i përfshirë në lypësi, endje ose prostitucion, i cili përdor droga dhe substanca tjera psikotropike dhe prekursorë ose alkool, e i cili për shkak të gjendjeve të këtylla është ose mund të bie ndesh me ligjin si viktimë ose si dëshmitar i veprimit që me ligj është paraparë si kundërvajtje ose veprim që me ligj është paraparë si vepër penale,

- **fëmijë në rrezik deri në moshën 14 vjet** është çdo fëmijë i cili në kohën e kryerjes së veprës së paraparë me ligj si vepër penale për të përcaktuar dënim me para ose burg mbi tri vite ose vepër e paraparë me ligj si kundërvajtje, i ka mbushur shtatë vjet, e nuk i ka mbushur 14 vjet,

- **fëmijë në rrezik nga 14 deri 18 vjet** është çdo fëmijë i cili në kohën e kryerjes së veprimit, të paraparë me ligj si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me para ose dënim me burg deri në tri vite ose vepër e paraparë me ligj si kundërvajtje, i ka mbushur 14 vjet e nuk i ka mbushur 18 vjet,

- **fëmijë që bie ndesh me ligjin nga 14 deri 16 vjet**, është çdo fëmijë i cili në kohën e kryerjes së veprimit të paraparë me ligj si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg mbi tri vite i ka mbushur 14 vjet e nuk i ka mbushur 16 vjet, fëmijë që bie ndesh me ligjin mbi 16 vjet është çdo fëmijë i cili në kohën e kryerjes së veprimit të paraparë me ligj si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg mbi tri vite, i ka mbushur 16 vjet e nuk i ka mbushur 18 vjet,

- **fëmijë viktimë është çdo fëmijë i moshës deri 18 vjet**, i cili ka pësuar dëm, duke përfshirë lëndim fizik ose mental, pësim emotiv, humbje materiale ose shkelje tjetër ose rrezikim të drejtave dhe interesave si pasojë e veprimit të kryer me ligj të paraparë si vepër penale, - person më i ri i moshës madhore është personi i cili gjatë kohës së gjyqimit për veprim të paraparë me ligj si vepër penale, i ka mbushur 18 vjet e nuk i ka mbushur 21 vjet,

- **masa** në kuptim të këtij ligji janë masat për ndihmë dhe mbrojtje të përcaktuara me ligj të cilat nuk përbëhen në heqjen dhe kufizimin e lirive dhe të drejtave të fëmijëve për shkak të veprimit të kryer të paraparë me ligj si vepër penale ose kundërvajtje ose gjendje të rrezikut, të cilat ndaj fëmijës, prindit/ëve, ose tutorit/ëve mund t'i zbatojnë, gjykata ose organet tjera të përcaktuara me këtë ligj,

- **sanksion** është pasoja juridike e veprimit e paraparë me ligj si vepër penale dhe shkelje, i cili përbëhet në ndihmë dhe mbrojtje, kufizim ose heqje të lirive dhe të drejtave të caktuara të fëmijës nga 14 deri 18 vjet për shkak të veprimit të paraparë me ligj si vepër penale ose shkelje, që e shqipton gjykata me procedurë të përcaktuar me këtë ligj,
- **gjykatë kompetente**, është gjykatësi për fëmijë dhe këshilli për fëmijë,
- **organe tjera** të specializuara janë Qendrat për punë Sociale, Prokuroria Publike, Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet për zbatimin e sanksioneve për fëmijë dhe - familje janë prindi/ët ose tutori/ët e fëmijës, farefisi i moshës madhore sipas gjakut në vijë të drejtë, motra ose vëllai, bashkëshorti, si dhe persona tjerë të moshës madhore me të cilët fëmija jeton në ekonomi familjare të përbashkët.

1.2. Mbrotja ligjore e Të Drejtave të Fëmijëve sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë

Shoqëria çdoher i ka kushtuar kujdes sjelljeve të të miturve, shikuar historikisht, kjo dukuri ka qenë prezente në çdo shoqëri. Është me interes të përmenden mendimet e filozofit grek Sokratit i cili qysh atëherë ka konstatuar se fëmijët tani dëshirojnë luks, se ata kanë sjellje të dobëta ndaj më të vjetërve dhe më shumë dëshirojnë të flasin se sa të mësojnë, fëmijët tani nuk ngrihen kur hyjnë më të vjetrit në dhomë.

Me përparimin e shoqërisë edhe sjelljet e pa pranueshme shoqërore të të miturve pësuan ndryshime dhe modifikime të caktuara si në planin e fenomenit të paraqitjes ashtu edhe në aspektin e kushteve dhe shkaqeve të cilat i shkaktojnë³.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e njëh Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës dhe korniza ligjore e R.Maqedonisë bazohet në standarde të ndryshme ndërkombëtare dhe rajonale që reflekton një zotim për realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe të të rinjëve.

Të Drejtat e Fëmijës janë përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë;

³A.Dida, Patologjia shoqërore e të miturve në Kosovë, Prishtinë, 1996, fq.37

Të drejtat e fëmijëve janë të mbrojtura dhe të siguruara edhe në bazë të Kushtetutës së RMV-së.

Neni 10 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut tregon se Jeta e njeriut është e pacënueshme

Neni 11 i Kushtetutës së RMV-ut Integriteti fizik dhe moral i njeriut janë të pacënueshëm Dinjiteti i njeriut është i pacënueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Secili person gëzon të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të tij/saj neni 26.

Neni 42- Republika, veçanërisht i mbron amësinë, fëmijët dhe personat e mitur. Personi më i ri se 15 vjeç nuk mund të punësohet. Personat e mitur dhe nënat kanë të drejtë në mbrojtje të veçantë gjatë punës. Personat e mitur nuk guxojnë të punësohen në vendet e punës, të cilat janë të dëmshme për shëndetin dhe moralin e tyre.

Neni 43 -Secili njeri ka të drejtë për mjedis të shëndetshëm jetësor. Secili e ka për detyrë ta përparojë dhe ta mbrojë mjedisin jetësor dhe natyrën. Republika siguron kushte për realizimin e të drejtës së qytetarëve për mjedis të shëndetshëm jetësor.

Neni 44- Secili ka të drejtë në arsimim. Arsimiti është i arritshëm për secilin në kushte të barabarta. Arsimiti fillor është i detyrueshëm dhe pa pagesë.

Neni 45- Qytetarët kanë të drejtë, në kushtet e përcaktuara me ligj, të themelojnë institucione private të arsimit në të gjitha shkallët e arsimit, përveçse në arsimin fillor.

1.3. Mbrotja ligjore sipas Kodit Penal të RMV-së

Kodi penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut ka paraparë si vepër penale: lënien pas dore dhe braktisjen e fëmiut në kreun XX, neni 201 në të cilën citohet se :

(1) Prindi, birësuesi, tutori apo personi tjetër i cili me lënien e vrazhdë pas dore të detyrimit të vet për përkujdesje dhe edukim do ta lë pas dore fëmijën apo do ta keqtrajtojë atë, do të dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet burg.

(2) Me dënim nga paragrafi 1 do të dënohet prindi, birësuesi tutori apo personi tjetër i cili e detyron fëmijën në punë që nuk i përgjigjet moshës dhe forcës fizike të tij apo nga levërdia e shtinë në lypësi apo në kryerje të veprimeve të tjera që janë të dëmshme për zhvillimin e tij.

(3) Nëse për shkak të veprave nga paragrafët 1 dhe 2 është paraqitur lëndim i rëndë trupor ose shkatërrim i rëndë i shëndetit të fëmijës ose fëmija ka filluar të merret me lypje, prostitucion ose forma të tjera të sjelljes asociale, kryerësi do të dënohet së paku 5 vjet burgim.⁴

Në bazë të nenit 202 te kodit penal të RMV-ut, dënohet edhe mosdhënia e mjeteve për jetesë si vijon:

(1) Ai që i shmanget dhënies së mjeteve për jetesë të caktuara në bazë të vendimit të prerë gjyqësor apo rrafshimit, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vjet.

(2) Gjatë shqiptimit të dënimit me kusht gjykata mundet që kryerësit t'i urdhërojë t'i paguajë obligimet e arritura dhe në të ardhmen në mënyrë të rregullt ta paguajë mirëmbajtjen.⁵

1.3.1. Moshë e përgjegjesisë penale sipas Kodit Penal të RMV-së

Edhe sot, çdo shoqëri njerëzore e organizuar si shtet nëpërmjet institucioneve të ndryshme (familjes, shkollës, organeve të entit social, medimeve, etj.) ndërmerr masa preventive me të cilat synon të pengojë kryerjen e veprave penale. Nuk ka dyshim se procesi i tillë i reagimit ndaj kriminalitetit është proces kompleks dhe i ndërlikuar por, i domosdoshëm. Megjithatë, nuk duhet pritur që procesi edukativ-preventiv, sado i rëndësishëm që është, të sjell deri te pengimi dhe zhdukja e plotë e kriminalitetit. Në këtë drejtim, është domosdoshmëri që shteti të angazhohet edhe në aspektin tjetër—në aspektin “represiv” të reagimit ndaj kriminalitetit⁶.

Vepra penale nuk kryejnë vetëm personat madhorë por, kryejnë edhe personat e mitur. Përkundër faktit se për nga shkalla e rrezikshmërisë shoqërore veprat penale të të miturve janë të njëjta, madje në disa raste edhe më të rrezikshme se veprat penale që kryhen nga personat madhorë megjithatë, trajtimi i tyre në të drejtën penale është shumë më i butë se ndaj

⁴ Neni 201 i Kodit Penal të RM-së

⁵ Po aty

⁶ Ejup Sahiti & Ismail Zejneli, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2017, fq.1

kryerësve madhorë të veprave penale. Kjo nga fakti se personat e mitur akoma gjenden në fazën e zhvillimit dhe të formësimit të tyre biopsiçik dhe si të tillë nuk janë në gjendje që plotësisht ta kuptojnë peshën e veprës dhe t'i kontrollojnë sjelljet e tyre⁷.

Pozita penalo-juridike e të miturve - është vetëm një rrethanë që kushtëzon zbatimin e masave të legjislacionit penal si mjet i fundit në luftimin e delikuencës së të miturve. Legjislacioni penal, edhe pse dukshëm e ka rregulluar pozitën penalo-juridike të të miturve, nuk ka arritur sa duhet të ndikojë në luftimin më të suksesshëm të delikuencës së të miturve. Mirëpo, edhe normat penalo-juridike më bashkëkohore nuk do të kenë efekte të pritura kriminalo-politike, nëse njëkohësisht nuk bëhen përtrirje përkatëse kadrovike, organizative dhe normative në zbulimin, gjykimin e të miturve dhe ekzekutimin e sanksioneve ndaj tyre⁸.

Sipas Kodit penal të Republikës së Maqedonisë persona të mitur konsiderohen personat prej moshës 14 deri në moshën 18 vjeçare, me një nëndarje persona të mitur të rinj prej moshës 14-16 vjet dhe persona të mitur të rinj prej moshës 16-18 vjet⁹.

Zbatimi i Kodit Penal ndaj të miturëve dhe personave madhorë më të rrinjë

Neni 6

1. Kodi Penal nuk zbatohet ndaj të miturit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale, e cila me ligj është paraparë si vepër penale, nuk i ka mbushur katërmbëdhjet vjetë.
2. Ndaj të miturve dhe personave madhorë më të rrinj për vepra penale të parapara me ligj apo me marëveshje ndërkombëtare të ratifikuara duke qenë në pajtim me Kushtetutën e Republikës Veriore të Maqedonisë, zbatohen dispozitat e këtij kodi nëse me ligj nuk është e paraparë më ndryshe.

⁷ Ismet Salihu, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 1995, fq.423

⁸ Vesel Latifi, E drejta, nr.1, Prishtinë, 1997, fq.28

⁹ Kodi penal i RM-së, Shkup, 1996

Sanksionet penale për të miturit deri në vitin 2007 janë paraparë me Kodin Penal të Maqedonisë Veriore, ndërsa me miratimin e Ligjit për të drejtat e të miturëve –LDM, e viti 2007 ceket kapitulli i tërë i KPM-së për sanksionet për të miturit dhe të njëjtat parashihen me LDP dhe sot me Ligjin për të drejtat e fëmijëve e vitit 2013, në nenin 4 të Kodit Penal – Sanksionet penale janë dëmet, masat alternative, masat e sigurisë dhe masat edukuese.

Kodi penal poashtu parasheh rrethana lehtësuese për veprat penale që në këtë rast moshë e kryerësve të veprave penale ajo jo madhore llogaritet në Gjykatë si rrethanë lehtësuese gjatë përzgjedhjes së sanksionit penal dhe matjes ligjore gjyqësore të dënimit përkatës për fëmijë.

Edhe Kodi penal për të mitur i Republikës së Shqipërisë në nenin 12, e përcakton moshën për përgjegjësi penale, në të cilin decidivisht thuhet; ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç. Ndërsa personi që kryen një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç. Gjithashtu, edhe në nenet 51 dhe 52 bëhet fjalë për të miturit, konkretisht për dënimin me burgim për të miturit dhe për përjashtimin e të miturit nga dënimi. Për të miturit, që në kohën e kryerjes së veprës penale nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç, dënimi me burgim nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikon ligji për veprën penale të kryer (neni 51 i KPSH). Ndërsa gjykata, nisur nga rrezikshmëria e vogël e veprës penale, nga rrethanat konkrete të kryerjes së saj, nga sjellja e mëparshme e të miturit, mund ta përjashtojnë atë nga dënimi. Në këto raste gjykata mund të vendosë dërgimin e të miturit në një institucion edukimi (neni 52 i KPSH).

Studiuesit përpiqen të shpjegojnë shkaqet e ndryshueshmërisë së krimit në varësi të grup moshës dhe faktorët që ndikojnë në përhapjen e krimeve në moshat e reja. Ata e vënë theksin në faktorë të ndryshëm, ndër të cilët më të rëndësishmit janë: përbërja demografike e popullsisë, rëndësia që ka grup moshë e re në shoqëri, aktiviteti i madh i këtyre moshave, mënyra e kalimit të kohës së lirë, kontaktet e shumta të të rinjve me njëri tjetrin, etj¹⁰.

¹⁰ V. Hysi, Kriminologjia, Tiranë, 2005, fq.123

Kërkimet kriminologjike lidhur me dukurinë e kriminalitetit kundër pasurisë dhe pjesmarrjen e personave të mitur, të rinj dhe fëmijëve tregojnë se rastet janë të shumta. Sipas kërkimeve kriminologjike, fëmijët dhe të miturit marrin pjesë në 45,7% të rasteve të paraqitura për këto krime. Te disa raste, pjesmarrja e tyre është edhe më e madhe, përshembull te krimet e vjedhjeve të zakonshme, vjedhjeve të imta, vjedhjes nëpër shitore, vjedhjes së automobilave ajo arrin deri në 50%. Moshë më e vjetër e kryerësve të këtyre krimeve sillet prej 20-25 vjet.¹¹

1.4. KONVETAT

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve është një traktat ndërkombëtar për të drejtat e njeriut i cili përcakton të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale, shëndetësore dhe kulturore të fëmijëve. Konventa, përcakton një fëmijë si çdo qenie njerëzore nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç, përveç nëse moshë madhore e tij është arritur më herët sipas legjislacionit përkatës kombëtar.

Kombet që ratifikojnë këtë konventë janë të obliguara ndaj saj me ligjin ndërkombëtar. Pajtueshmëria monitorohet nga Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, i cili përbëhet nga anëtarë prej vendeve të ndryshme të botës.

Një herë në vit, Komiteti i paraqet një raport Komisionit të Tretë të Asamblesë së përgjithshme të Kombeve të Bashkuara i cili gjithashtu dëgjon një deklaratë nga Kryetari i Komitetit të Drejtave të Fëmijëve, dhe Asambleja miraton një Rezolutë për të Drejtat e Fëmijëve.

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara-ka miratuar Konventën dhe e ka ofruar atë për nënshkrim më 20 nëntor të vitit 1989 (30 vjetori i Deklaratës së saj për të Drejtat e Fëmijëve). Ajo hyri në fuqi më 2 shtator 1990, pasi u ratifikua nga numri i kërkuar i kombeve.

Duke njohur se Kombet e Bashkuara, në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe në paktet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, kanë shpallur dhe kanë pranuar se secilit i takojnë të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në to, pa asnjë dallim race, ngjyre, gjinie, gjuhe, feje, opinionit politik ose çdo lloj opinionit tjetër, origjine kombëtare ose shoqërore, pasurie, prejardhjeje ose çdo lloj gjendjeje tjetër.

¹¹ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2016, fq.211

Duke rikujtuar se në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Kombet e Bashkuara kanë shpallur që mosha e fëmijërisë ka të drejtë për një përkujdesje dhe përkrahje të veçantë, të bindur se familja, si njësi themelore e shoqërisë dhe mjedis natyror për rritjen dhe mirëqenien e të gjithë anëtarëve të saj veçanërisht të fëmijëve, duhet të ketë mbrojtjen dhe ndihmën e nevojshme që të mund të marrë përsipër plotësisht rolin e saj në bashkësi, duke njohur se fëmija, për zhvillimin e plotë dhe të harmonishëm të personalitetit të tij, duhet të rritet në një mjedis familjar, në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi.

Duke pasur parasysh se fëmija duhet të përgatitet plotësisht për të bërë një jetë individuale në shoqëri dhe të edukohet në frymën e idealeve të shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe sidomos në frymën e paqes, të dinjitetit, tolerancës, lirisë, barazisë dhe solidaritetit.

Duke mbajtur parasysh se nevoja për t'i dhënë një mbrojtje të posaçme fëmijës është theksuar në Deklaratën e Gjenevës për të Drejtat e Fëmijës të vitit 1924 dhe në Deklaratën për të Drejtat e Fëmijës të miratuar nga Kombet e Bashkuara më 20 nëntor të vitit 1959 dhe që është njohur në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (në veçanti në nenet 23 dhe 24), në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (në veçanti në nenin 10) dhe në statutet e instrumentet përkatëse të agjencive të specializuara dhe të organizatave ndërkombëtare, që merren me mirëqenien e fëmijëve¹²

Konventa e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimet seksuale. Gjatë samitit të tretë të Kryetarëve të shteteve dhe të Qeverive të Këshillit të Evropës u miratua një plan-veprim (Varshavë, 16-17 maj 2005), për përgatitjen e masave për ti dhënë fund shfrytëzimit seksual të fëmijëve.¹³ Më pas disa nga Ligjet dhe vendimet e Bashkimit Evropian; vendimi në lidhje me luftën kundër shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pedopornografisë (2004/68/JAI), vendimi në lidhje me statusin e viktimave në kuadrin e procedimeve penale (2001/220/JAI) dhe vendimi në lidhje me luftën kundër trafikimit të qenieve njerzore (2002/629/JAI). Po ashtu Konventa e Kombeve të Bashkuara në lidhje me të drejtat e fëmijëve e vitit 1989 (neni 34), Protokollin fakultativ mbi shitjen e fëmijëve,

¹² Wikipedia

¹³ Grup autorësh, E drejta Penale Evropiane (përkthim), Tiranë, 2009, fq.209

prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë, si dhe Protokollin shtesë të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër kriminalitetit transkombëtar të organizuar, i cili synon parandalimin dhe dënimin e fenomenit të trafikimit të personave, sidomos të grave dhe fëmijëve.¹⁴

Në preambulën dhe në nenet 5, 10 dhe 18-të, Konventa për të drejtat e fëmijëve në mënyrë të veçantë i referohet familjes si grup themelor i shoqërisë dhe si mjedis i natyrshëm për rritjen dhe mirëqenien e antarëve të saj, në mënyrë të veçant për fëmijët. Shtetet janë të obliguara të respektojnë përgjegjësinë primare të prindërve për ofrimin e kujdesit dhe udhëzimeve ndaj fëmijëve të tyre dhe ti përkrahin ato duke u dhënë mbështetje të përgjithëshme. Shtetet palë respektojnë përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat që kanë prindërit ose sipas rastit antarët e familjes së zgjeruar, kujdestarët ose personat e tjerë që janë sipas ligjit përgjegjës për fëmijët, për t'iu siguruar atyre në përputhje me zhvillimin e aftësive të tij, drejtimin dhe udhëheqjen e duhur për ushtrimin e të drejtave të njohura në këtë Konventë (neni 5).

1.5. Mbrojtja ligjore sipas Kartës sociale për të drejtat e fëmijëve

Karta Sociale Evropiane është një nga traktatet bazë të Keshillit të Evropës i cili u miratua më 18 tetor të vitit 1961 ndërsa hyri në fuqi më 26 shkurt 1965, kur 13 vendet nënshkruese e ratifikuan atë. Deri në vitin 1991, 20 vende e kishin ratifikuar dokumentin në fjalë.

Karta Sociale Evropiane është reviduar në vitin 1996. Karta e Rishikuar hyri në fuqi në vitin 1999 dhe gradualisht e zëvendësoi traktatin fillestar të vitit 1961. Karta përcakton disa nga të drejtat dhe liritë e njeriut dhe krijon një mekanizëm mbikëqyrës që garanton respektimin e tyre nga shtetet palë.

Karta garanton të drejtat dhe liritë të cilat u përkasin të gjithë individëve në ekzistencën e tyre të përditshme. Të drejtat themelore të përcaktuara në Kartën janë: strehimi, shëndetësia, arsimi, punësimi, mbrojtja sociale dhe ligjore, lëvizja e lirë e personave dhe jo-diskriminimi.

¹⁴ Po aty

Shtetet palë në Kartë kanë detyrimin për të dorëzuar raporte vjetore mbi një pjesë të dispozitave të Kartës (qoftë Kartës te vitit 1961 ose Kartën e Rishikuar të vitit 1996), ku tregojnë se si i zbatojnë këto të drejta në të drejtën e brendshme dhe në praktikë.

Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale (KEDS) është organi përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë së shteteve palë me kërkesat e Kartës.

KEDS përbëhet nga 15 anëtarë të pavarur dhe të paanshëm të cilët zgjidhen nga Komiteti i ministrave të Keshillit të Evropës Komiteti i Ministrave për një mandat gjashtë vjeçar, i rinovueshëm një herë.

Në bazë të Protokollit Shtesë të vitit 1995 për një sistem të ankesave kolektive, i cili hyri në fuqi në vitin 1998, KEDS-së mund t'i drejtohen ankesa për shkelje të Kartës në shtetet palë. Ankesat janë të një natyre kolektive (një shkelje e konstatuar në të drejtën e një vendi ose situatave në praktikë të cilat përbëjnë shkelje të Kartës dhe jo raste individuale) dhe duhen dorëzuar prej organizatave të autorizuara nga protokollin shtesë.

Organizatave që përmbushin kriteret e përcaktuara në Protokollin e 1995, kanë të drejtë për të paraqitur ankesa përpara KEDS (ekziston një listë të veçantë e OJQ-ve, e përbërë nga OJQ-të që gëzojnë status pjesëmarrës në Keshillin e Evropës KEDS shqyrton ankesën dhe, nëse përmbushen kërkesat formale, e deklaron atë të pranueshme dhe e shqyrton ankesën në themel¹⁵.

¹⁵ Po aty

KAPITULLI I II-të

2.1.Dhuna ndaj fëmijëve nëpër shkolla në Maqedoni

Dhuna ndaj fëmijëve është shkelje e lirive dhe të drejtave të fëmijëve, kjo shkelje e të drejtave shpesh mbetet larg syrit të opinioneve, larg njohurisë së organeve dhe institucioneve shtetërore, të cilat janë të parapara që ti ndihmojnë dhe ti shpëtojnë fëmijët. Për këtë arsye, veprimet kriminale të dhunës ndaj fëmijëve, në të shumtën e rasteve nuk paraqiten fare ose paraqiten në numër tejet të vogël, edhe atëherë kur paraqiten këto raste nuk procedohen deri në fund, ngase shumë vështirë argumentohen veprimet e dhunës në familje ndaj fëmijëve.¹⁶

Dhuna ndaj fëmijëve është njëri nga problemet më serioze që rrezikon zhvillimin e tyre, shëndetin dhe mirëqenien, të drejtat themelore, dinjitetin dhe mundë të sjell në pyetje jetën e fëmijëve. Ndodhën gjithkund, në shtëpi, në shkollë apo në institucione tjera për kujdesi të fëmijëve, në rrugë. Pjesa më e madhe e dhunës ndaj fëmijëve mbetet e fshehur. Fëmijët kanë frikë ta paraqesin për shkak se frikësohen ose për shkak të lidhjes që kanë me përdhunuesin apo dhunën aspak nuk e konsiderojnë si diçka të gabueshme ose të jashtëzakonshëm por e shohin si ndëshkim të justifikuar për veprimet e tyre. Fëmijë që janë viktimë e dhunës mundet të ndjehen fajtorë dhe të besojnë se e meritojnë dhunën. Gjatë historisë, por edhe sot në kultura të ndryshme ndëshkimi fizik ka qenë dhe është njëra nga mënyrat për disiplinimin dhe edukimin e fëmijëve si në familje ashtu edhe në shkollë.

Siguria dhe ndjenja e sigurisë të fëmijët në shkollë, si të drejta dhe nevoja themelore mund të sjellën në dyshim si pasojë e përvojës së hershme të dhunës. Siguria e fëmijëve në shkollë paraqet bazë për ndjenjën e përkatësisë shoqërore, si dhe për atmosferën e besimit dhe bashkëpunimit.

Hulumtimi i cili u bë në kuadër të projektit Shkolla sipas masës së fëmijëve (dimensioni Shëndetësi, siguri dhe mbrojtje) i përket kornizës ligjore, dmth, politikës dhe procedurave për

¹⁶ M.Valer, Delikuenca e të miturve, Shkup, 2011, fq.40

shëndetësi, siguri dhe mbrojtje në shkollat në Republikën e Maqedonisë. Të dhënat e fituara në katër shkolla në vendin tonë tregojnë se:

- në të shumtën e shkollave nuk ka politikë të veçantë të shkruar për të gjitha format e dhunës fizike;
- në të gjitha shkollat nuk bëhet dallim në mes dhunës (maltretim, shqetësim, rrahje, abuzim dhe neglizhim) dhe ndëshkimit trupor, arsimtarët në fjalë e citojnë Ligjin për Arsim Fillor sipas së cilit është i ndaluar vetëm ndëshkimi truporë, përderisa llojet e tjera të dhunës as që përmenden;
- nuk ka rregullativa të veçanta të cilat rregullojnë këto lloje të sjelljes, ka vetëm në disa shkolla edhe atë në formë të Kodeksit për sjelljen e mësimeve, me anë të së cilës rregullohet sjellja e mësimeve. Kodeksi për sjelljen e nxënësve me anë të së cilës rregullohet sjellja e nxënësve dhe marrëdhëniet në mes tyre në kuptim të sjelljes jo të dhunshme, si dhe rregullore për rendin e shtëpisë në të cilin rregullohen marrëdhëniet mes nxënësve, arsimtarëve dhe të punësuarve në kuptim të jo dhunës.
- në disa shkolla ku nuk ka kodekse të shkruara, marrëdhëniet mes arsimtarëve dhe nxënësve rregullohen me anë të leximit të rregullave për sjellje në orët e kujdestarisë, të arsimtarëve në mbledhjet e këshillit, dhe mandej informacioni i tillë vendohet në dërrasën për lajmërim, që të mundën të shohin të gjithë;
- masa discipline për sanksionimin e sjelljes së dhunshme të nxënësve janë të shkruara në Rregulloren për masa pedagogjike, a për arsimtarët në Ligjin për marrëdhënie pune; masat ndaj nxënësve sjellën hap pas hapi (para përjashtim, përjashtim në klasë apo shkollë tjetër) me anë të së cilës jepet mundësi nxënësi të përmirësohet:
- nuk ka të dhëna 5 vitet e fundit se për shkak të sjelljes së dhunshme nga ana e arsimtarëve ndonjëri prej arsimtarëve është dënuar, përveç në një shkollë ku është larguar një arsimtare;
- në dy shkolla janë dënuar tre nxënës me largimin në shkollë tjetër. Të thënat e fituara në Studimin për sjellje që ka të bëjë me shëndetin e fëmijëve në moshën


shkollore në R. e Maqedonisë [6] prej vitit 2006 në mostër prej 4147 nxënës 11, 13, dhe 15 vjeçar janë gjetur të thënat e mëposhtme. 7 Fëmijë të cilët ndonjëherë kanë qenë të maltretuar në shkollë:

- 7% prej vajzave dhe 14% prej djemve në moshën 11 dhe 13 vjeçare;
- 5% vajza dhe 8% djem në moshën 15 vjeçare Fëmijë të cilët ndonjëherë kanë marrë pjesë në maltretim:
- 7% prej vajzave dhe 13% prej djemve në moshën 11 vjeçare;
- 6% prej vajzave dhe 21% prej djemve në moshën 13 vjeçare;
- 7% prej vajzave dhe 20% prej djemve në moshën 15 vjeçare;

Sa ju përket zënkave hulumtimi tregon përqindje të madhe të nxënësve 15% për vajzat dhe 40% për djemtë të cilët kanë qenë pjesëmarrës.

Kjo e dhënë e vendosë Republikën e Maqedonisë në vendin e 5 në krahasim me 46 shtetet tjera pjesëmarrëse në Studim. Për nxënësit që kanë marrë pjesë në zënka më e besueshme është se pinë duhan dhe dehen, ndjehen të vetmuar, të pa pranuar, të pasigurt në vete dhe nervoz, tregojnë të dhënat nga Studimi. Përqindje e madhe e nxënësve paraqesin se kanë mbajtur armë 30 ditëve të fundit, edhe atë djemtë shumë më shumë se vajzat. Përqindja e nxënësve të cilat mbajnë armë është më e madhe në moshën 15 vjeçare: 12% për djemtë etnik maqedonas dhe 22 % për për djemtë etnik shqiptarë¹⁷.

¹⁷ Unicef



Familja dhe raportet e shëndosha familjare, është thënë kaheerë, janë parakushte themelore për një gjeneratë të re të suksesshme dhe për një shoqëri stabile, me perspektivë të sigurtë për të ardhmen. Konfliktet familjare, konfliktet burrë-grua, konfliktet prindër-fëmijë, divorcet e shumta, braktisja e familjes, braktisja e fëmijëve, çdo ditë e më tepër shtojnë numrin e viktimave¹⁸. Si sjellje të dhunës në familje ose si kriminalitet të dhunës në familje në literaturën kriminologjike, zakonisht cilësohen disa forma të dhunës që manifestohen me dhunë në martesë, pra, dhunën në mes bashkëshortëve, burrit dhe gruas, me dhunën ndaj fëmijëve dhe dhunën ndaj prindërve.


Dhuna në familje, degradimi i raporteve të burrit dhe gruas, shpiejnë edhe tek abuzimi i fëmijëve, te prania e dukurive patologjike të prindërve si p.sh.: tek alkooli, droga, bixhozi, prostitucioni, bredhja dhe sjelljet tjera destruktive në dëm të fëmijëve. Në këtë kontekst, vërehet dukuria e lënies pas dore të fëmijëve, keqtrajtimi i tyre fizik dhe psikik, abuzimi seksual

¹⁸ Ragip Halili, Viktimologjia, Prishtinë, 2007, fq.114

dhe detyrimi i tyre në punë të rënda dhe të pamoralshme, si: detyrimi që të vjedhin, detyrimi që të lypin rrugëve dhe veprime tjera të dëmshme për fëmijët¹⁹.

Dhuna ndaj fëmijëve kohëve të fundit është bërë objekt i studimeve, konferencave dhe debateve edhe në Shqipëri. UNICEF zhvilloi një studim në lidhje me dhunën ndaj fëmijëve në Shqipëri, ku ofroi informacion të bollshëm mbi nivelin e dhunës ndaj tyre. Organizata Save the Children ndërmoi gjithashtu kohëve të fundit një studim në lidhje me dhunën ndaj fëmijëve në ambientet e shkollës. Gjithashtu edhe studime të tjera e kanë prekur këtë fenomen duke e vënë atë në fokus parësor apo dytësor.²⁰

Në pyetjen parashtruar fëmijëve, a të kanë ofenduar ndonjëherë, përgjigja ka rezultuar se 45,26% e fëmijëve janë përgjigjur me jo, ndërsa 54,74% janë përgjigjur me po. Ndërsa në pyetjen e parashtruar fëmijëve nëse të kanë ofenduar, kush?, përgjigja ka rezultuar si vijon; pjestar të familjes dhe moshatar 1, 32%, mësuesja dhe moshatar 9,65%, mësuesja dhe pjestar të familjes 3,29%, mësuesja 29,17%, moshatarët 32,02%, pjestar të familjes 17,32%, të gjithë 4,39%, ndërsa pa përgjigje nuk ishte asnjë fëmijë.²¹



¹⁹ Po aty,

²⁰ Legjislacioni Shqiptar dhe Konventa e të drejtave të fëmijëve, Tiranë, fq.520

²¹ Po aty

Nga kërkimet e shumta kriminologjike, target i dhunës janë zakonisht fëmijët e padëshiruar, fëmijë që rrjedhin nga incesti, fëmijë si pasojë e dhunimit seksual, fëmijët që kanë lindur pa dëshirën e nënës, ato që lindin gjatë krizave të ndryshme ekonomike, gjatë varfërisë, fëmijët që lindin me të meta fizike apo psiqike.

2.4.Dita ndërkombëtare e Të Drejtave të Fëmijëve

Fëmijët janë një grup shoqëror mjaft i ndjeshëm, që lehtë mund të ekspozohet ndaj keqtrajtimit dhe dhunës, prandaj paraqitet nevoja për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Fëmijët për çdo ditë janë të ekspozuar ndaj dhunës, eksploatimit, viktimizimit nga të rriturit, por edhe ndaj urisë, sëmundjeve dhe mungesës së kushteve socio-ekonomike për një jetë të shëndetshme dhe aktive në vendet e varfra ose vendet në zhvillim. Problem shtesë për fëmijët është qasja në edukim, shfrytëzimi i punës së fëmijëve për të lypur, punë në fabrikë dhe si pjesë e industrisë jolegale seksuale. Një nga problemet më të mëdha me të cilin po përballet bota është tregtia ilegale me fëmijë dhe organe, që është më prezente në mjediset ku fëmijët nuk kanë kushte për marrjen e dokumenteve personale.²²

Asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1954 e shënoi 20 nëntorin si Ditën Botërore të fëmijëve, që ka për qëllim të sigurojë mirëqenie për të gjithë fëmijët në botë dhe t'i rikujtojë të rriturit se fëmijët, si anëtarë të barabartë të çdo shoqërie, kanë të drejtat e tyre dhe ato duhet të respektohen.

Asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1959 e miratoi Deklaratën për të drejtat e fëmijëve, ndërsa në vitin 1989 u miratua edhe Konventa për të drejtat e fëmijëve të cilën Republika e Maqedonisë e ratifikoi në vitin 1993.

Qëllimi i shënimit të Ditës Botërore të fëmijëve është të kthejë vëmendjen e publikut të gjerë tek detyrimet që një shoqëri i ka ndaj fëmijëve, si dhe tek problemet më të rëndësishme të cilat përballen fëmijët.

²² Instituti I Shëndetit Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Edhe në Republikën e Maqedonisë fëmijët përballen me rrezikun për tu bërë viktime të tregtisë ilegale me fëmijë dhe organe njerëzore, detyrimi për të kryer punë seksuale dhe shfrytëzim të mundit të fëmijëve duke i detyruar ato të punojnë në rrugë. Më të ekspozuar janë fëmijët e komunitet rom si një grup vulnerabël dhe i marginalizuar. Ato hasin në probleme gjatë regjistrimit në librin amë të të lindurve dhe gjatë marrjes së dokumenteve personale.²³

Zyra e UNICEF thekson se në Maqedoni pas ratifikimit të konventës për të drejtat e fëmijëve të vitin 1993 para ditëlindjes së tyre të 5 vdesin më pak fëmijë, më shumë fëmijë kanë qasje në mësim në shkolla fillore dhe më pak fëmijë jetojnë nëpër institucione. Megjithatë, në raport thuhet se vazhdon të jetë i madh numri i fëmijëve të privuar, të stigmatizuar dhe atyre të përjashtuar nga shoqëria. 52% e të gjithë fëmijëve në moshë nga 2 deri më 14 vjet kanë qenë viktime të dhunës fizike në shtëpi, thonë nga UNICEF.

2.5.Organizata për të drejtat e Fëmijëve -Unicef

UNICEF-i punon në partneritet me qeverinë për të siguruar përfshirjen shoqërore të fëmijëve dhe grave, duke përfshirë grupet më të cënueshme të popullsisë. Politikat që trajtojnë nevojat shëndetësore, ushqimore, arsimore dhe zhvillimore të fëmijëve të vegjël në moshën kritike 0-3 vjeç dhe 3-6 vjeç, veçanërisht nevojat e atyre që vijnë nga familje të cënueshme. ²⁴

Mbrojtje dhe drejtësi për fëmijët-

- Deri në vitin 2021, të garantohet akses cilësor në sistemin e drejtësisë, duke përfshirë fëmijët që janë viktime ose dëshmitarë të krimit, dhunës, abuzimit;
- Reforma e sistemit kujdesit shoqëror, që ofron këshillim individual dhe udhëzime referencë për fëmijët, gratë dhe familjet në rrethana jetësore të vështira;

Fuqizim i kapacitetit të praktikantëve social dhe atyre për mbrojtjen e fëmijës për t'i ndihmuar familjet në situata cënueshmërie/në rrezik ndarjeje;

Shtimi i numrit të mekanizmave kombëtarë, që mbledhin të dhënat dhe adresojnë dhunën ndaj fëmijëve;

²³ Po aty

²⁴ Unicef, Shqipëri

Strategjitë

- UNICEF-i, në partneritet me qeverinë, vepron në mënyrë të tillë që të gjithë fëmijët të regjistrohen në shkollë, ta frekuentojnë atë dhe të pajisen me mjetet bazë për të patur sukses në jetë. Ne nxisim politikat miqësore me fëmijët, që parandalojnë dhe reduktojnë marginalizimin në arsim.

UNICEF-i vepron në mënyrë të tillë që të sigurojë që fëmijët të mbijetojnë dhe të zhvillohen deri sa të arrijnë moshën madhore. UNICEF-i advokon fort për mundësinë e barabartë për financim dhe akses në kujdesin shëndetësor, për grupet më të cënueshme të cilat kanë më shumë nevojë për kujdes shëndetësor dhe që nuk mund ta përballojnë nga ana financiare.

Për sa iu përket fëmijëve në konflikt me ligjin, UNICEF-i ofron mbështetje për zbatimin e ligjeve dhe reduktimin e kohës së qëndrimit të të rinjve në qendrat e paraburgimit.

Bota që ne duam të ndërtojmë është ajo ku vajzat dhe djemtë nuk dhunohen, shfrytëzohen dhe ndahen pa kurrfarë arsyeje nga familjet e tyre, dhe ku ligjet, shërbimet, sjelljet dhe praktikat minimizojnë nivelin e cënueshmërinë së fëmijëve.

☑ UNICEF-i po punon për të reduktuar pabarazitë dhe për ta ndihmuar qeverinë me reformën e mbrojtjes sociale, derisa të jetë e vlefshme për fëmijët.

2.6. Iniciativat e OJQ-ve të tjera mbi mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Maqedoni

Në Republikën e Maqedonisë janë të themeluara numër i madh i organizatave joqeveritare, të cilat shumica veprojnë në sferën e mbrojtjes së fëmijëve dhe të drejtave të tyre. Ato mund të kenë rol plotësues me institucionet tjera publike dhe shtetërore në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve por, poashtu paraqiten edhe si korigjuese, ose si organizata të cilat ofrojnë shërbime plotësuese dhe ndihmë në raste kur nuk ekzistojnë institucione publike të specializuara për qëllime të caktuara. Organizatat joqeveritare ofrojnë shërbime të ndryshme, mes tjerash:

Ndihmë dhe mbrojtje direkte fëmijëve; Ngritjen e vetëdijes publike për të drejtat e fëmijëve; Lobim dhe përfaqësim për ndryshime dhe plotësime të rregullativë ligjore; Trajnime të personave nga sektori publik dhe privat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, ndërtim të kapaciteteve dhe sigurim të përkrahjes tjetër publike²⁵.

Në listën e “Informatorit për subjektet të cilët punojnë në sistemin e drejtësisë për të mitur”, të publikuar nga Këshilli Shtetëror për parandalimin e delikuencës së fëmijëve (Prill, 2013), janë të evidentuara gjithsej 44 organizata joqeveritare të cilat veprojnë në sferën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Po përmendim disa nga ato, si: Asociacioni për mbështetje të fëmijëve dhe familjeve në rrezik; Asociacioni për promovim të shëndetit mental dhe parandalim të keqpërdorimit të fëmijëve “Fëmijëri e sigurtë”; Ambasada e parë botërore e fëmijëve “Megjashi”- R.M.; Shpëtoni fëmijët; Komiteti i Helsinkut për të drejtat e njeriut i R.M.; Asociacioni i qytetarëve SOS “Fshati i fëmijëve”; Asociacioni për të drejtat e fëmijëve – Qendra ditore për fëmijët në rrugë etj.

Në vazhdim, do të paraqesim veprimtarinë e dy organizatave joveritare të cilat kanë realizuar bashkëpunim me Këshillin gjatë vitit 2015, dhe ato janë: “SOS Fshati i fëmijëve”, dhe “Asociacioni për të drejtat e fëmijëve”. “SOS Fshati i fëmijëve”: Programi preventiv në kuadër të kësaj organizate joqeveritare funksionon nga viti 2007, në dy lokacione në qytetin e Shkupit, përmes dy Këshillimoreve- qendra për fëmijë dhe prindër. Grupi target i tyre janë familjet me fëmijë të mitur, ku fëmijët janë në rrezik për ta humbur kujdesin e prindërve/kujdestarëve, për shkak të prezencës së një apo më shumë gjendjeve të rrezikut social me të cilat ballafaqohen familjet.

Prej themelimit e deri në nëtor të vitit 2015, përmes këtyre dy Qendrave këshilldhënëse janë përkrahur gjithsej 746 fëmijë nga 215 familje, me 260 nga 212 prindër/kujdestarë. Nga ky numër 41 familje me 180 fëmijë bëjnë pjesë në kategorinë e fëmijëve të rrugës. Në të dy Qendrat përmes ndihmës me këshillëdhënie dhe punëtorive ofrohet mbështetje arsimore, psiko-sociale dhe shëndetësore për fëmijët, mbështetje për prindërit, edukim për zhvillim të hershëm të fëmijëve, mbështetje për sigurim të qëndrueshmërisë ekonomike të familjeve dhe

²⁵ INFORMATOR për subjektet të cilët punojnë në sistemin e drejtësisë për të mitur, 2013, fq.55

ndërtim të kapaciteteve të prindërve. Kjo organizatë ofron edhe shërbime të tjera plotësuese për familjet në rrezik social²⁶.

“OJQ Asociacioni për të drejtat e fëmijut”: Kjo organizatë joveritare e zhvillon “

Qendrën ditore edukative dhe zbavitëse për fëmijët në rrugë” në Shuto Orizar, e cila qendër është e themeluar nga viti 2007 dhe deri më sot ajo ofron ndihmë dhe mbrojtje për fëmijët dhe familjet e tyre. Qendra ditore për fëmijë punon me grupe të fëmijëve në rrugë nga bashkësia rome, në komunën e cekur më lartë. Këto janë fëmijë nga familje sociale rome me shumë fëmijë, të moshave 4-17 vjeçarë, të cilët nuk janë të kyçur në sistemin edukativo-arsimor, dhe kohën më të madhe e kalojnë rrugëve, të kyçur në lypsari apo duke jetuar në kushte të pavolitshme banesore dhe materiale (Raporti për 2015 i Këshillit SHPDF, 2016, f.47) . Bëhet fjalë për preventivë primare, me ç’rast në Qendër adresohen shkaqet apo faktorët kryesorë ende para se fëmijët të bëhen pjesë e sistemit të delikuencës së fëmijëve, me qëllim që të sigurohet një mjedis i sigurtë për të gjithë fëmijët. Në këtë Qendër Ditore mundësohen nevoja të ndryshme për fëmijët, si: Mbajtja e higjienës personale, ndjekja e fëmijëve në aspektin shëndetësor, bashkëpunim me institucionet shëndetësore për sigurimin e mbrojtjes shëndetësore të fëmijëve, imunizim dhe edukim shëndetësor për fëmijët, mbathje, ushqim, angazhim në aktivitete të dobishme.²⁷

Qëllimi kryesor i programit të punës së Qendrës ditore për fëmijët e rrugës është integrimi social dhe ndërprerja e ciklit të marginalizimit të tyre, respektivisht largimi i tyre nga rruga dhe kyçja në rrjedhat e rregullta të jetës. Kjo Qendër tashmë dhjetë vite ofron mbështetje të gjatë për përmirësimin e shkallës së regjistrimit, ndjekjes dhe mbarimit të sistemit edukativo-arsimor për kategorinë e fëmijëve në fjalë. Gjatë vitit 2015, Qendrën ditore e kanë vizituar 143 fëmijë, nga të cilët në vitin akademik 2014/15 shkollën e kanë vijuar 84 dhe 81 e kanë mbaruar atë me sukses²⁸.

²⁶ Raporti për vitin 2015 i Këshillit SHPDF, 2016, fq.46

²⁷ Raporti për vitin 2015 i Këshillit SHPDF, 2016, fq.47

²⁸ Raporti për vitin 2015 i Këshillit SHPDF, 2016, fq.48

KAPITULLI I III-të

3.1. Roli i ligjit të ri për të miturit

Përmbajtja, qëllime dhe parime themelore të Ligjit të ri për fëmijë e vitit 2013

Arsyeja e miratimit të këtij ligji i cili është gati 80% në përmbajtje i njëjtë me ligjin e vitit 2007, vjen si pasojë e miratimit të konventave për të drejtat e fëmijëve nga ana e Republikës së Maqedonisë. Miratimi i konventave nga ana e Parlamentit i cili i obligon të gjitha shtetet nënshkruese të kësaj konvente që të kenë një sistem juridiko-penal për fëmijë të verifikuar respektivisht të rregulluar me ligj të posaçëm në pajtim me dispozitat e kësaj konvente.

Republika e Maqedonisë në këtë drejtim ka shënuar progres të madh me disa shtete fqinje siç është Shqipëria e Kosova, duke e miratuar ligjin në vitin 2013 dhe duke i bërë disa ndryshime nga ligji paraprak i vitit 2007, si për shembull unifikimi i termit “Fëmijë”, për të gjithë personat deri në moshën 18 vjeçar dhe duke larguar tërësisht nga terminologjia emërtimin i “mitur”, përveç tërë asaj që u elaborua më lartë lidhur me përmbajtjen e LDF-se -Ligji për të drejtat e fëmijëve.

Roli i këtij ligji është fryma e njëjte e cila propagandohet me Konventën evropiane për Fëmijë e cila ka të bëjë me zhvillimin e drejt të fëmijëve dhe mbrojtjen e interesit të tij, respektivisht zhvillimi i mirëqenies tek fëmijët të cilët bien në konflikt me ligjin.

Neni 1

1. Me këtë ligj rregullohen veprimi me fëmijët në rrezik dhe me fëmijët kryerës të veprave që me ligj janë paraparë si vepra penale dhe kundërvajtje, përcaktohen kushtet për zbatimin e masave për ndihmë, kujdes dhe mbrojtje, masave edukuese dhe masave alternative dhe për dënimin e fëmijëve dhe personave më të rinj të moshës madhore, pozita, roli dhe kompetenca e organeve që marrin pjesë gjatë veprimit me fëmijët dhe zbatimi i masave të edukimit dhe masave alternative dhe dënimeve.

2. Me këtë ligj rregullohen masat për mbrojtjen e fëmijëve viktima të veprave, që me ligj janë paraparë si vepra penale, dhe të fëmijëve dëshmitarë dhe masat për preventivën e delikuencës së të miturve.

2. Qëllime të Ligjit

Qëllimet e ligjit dhe të zbatimit të tij janë realizimi i interesit prioritar dhe mbrojtja e fëmijëve nga kriminaliteti, dhuna dhe nga cilado formë e rrezikimit të lirive dhe të drejtave të tyre dhe zhvillimit të tyre të drejtë, mbrojtja e fëmijëve kryerës të veprave të cilat me ligj janë paraparë si vepra penale dhe kundërvajtje dhe nga përsëritja e atyre veprave, socializimi i tyre, edukimi dhe riedukimi, ndihma dhe kujdesi për fëmijët dhe mbrojtja në procedurë para gjykatës dhe organeve tjera, të lirive dhe të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, me Konventën për të drejtat e fëmijës dhe me marrëveshjet tjera ndërkombëtare për pozitën e fëmijëve, të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë²⁹.

3. Parime themelore

1. Në procedurë me fëmijë, gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik³⁰.
2. Dispozitat e Ligjit për përdorimin e gjuhës që e flasin së paku 20% të qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe në njësitë e vetëadministrimit lokal në mënyrë adekuate zbatohen në procedurë me fëmijë.
3. Fëmija-shtetas i huaj i privuar nga liria ose në paraburgim, parashtresat në procedurë mund t'i parashtrojë në gjuhën e vet, ndërsa në raste tjera në kushte të reciprocitetit.

²⁹ Neni 2, i Ligjit për drejtësinë e të miturve

³⁰ Po aty, neni 3

Fëmija ka të drejtë të informohet nga të gjitha institucionet, që janë në lidhje me të, për të drejtat e tij, të cilat përfshijnë obligime dhe përgjegjësi me Konventën për të drejtat e fëmijës dhe dokumentet tjera ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës, me këtë ligj dhe me ligje tjera.

Fëmija ka të drejtë të merret në pyetje dhe të dëgjohej dhe të këshillohet për të drejtat në atë procedure dhe për vetë procedurën.

4.Në çdo procedurë gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në të cilën merr pjesë, fëmija ka të drejtë në mënyrë aktive të marrë pjesë në marrjen e vendimeve në jetën e tij dhe ta japë mendimin e vet.

Fëmijës mbi moshën 14 vjet nuk mund t'i shqiptohet sanksion për veprën e cila para se të jetë kryer nuk ka qenë e paraparë me ligj si vepër penale ose si kundërvajtje dhe për të cilën nuk është përcaktuar sanksion me ligj ose me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare³¹.

Parimi i interesit më të lartë të fëmijës- sipas nenit 10 të KDPM të R.Shqipërisë, Organet kompetente në çdo vendim dhe veprimtari të ndërmarrë në zbatim të këtij Kodi, duhet të vlerësojnë me përparësi interesin më të lartë të të miturit. Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh³²:

- a) nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri, si dhe rritjen/përkatësinë në një familje;
- b) mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;
- c) historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;

³¹ Po aty, neni 5

³² Ismail Zejneli, Delikuenca e të miturve, Tetovë, 2018, fq.33

ç) aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës;

d) vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore. Vendimet dhe aktet e organeve kompetente duhet të përmbajnë një argumentim të posaçëm lidhur me mënyrën se si është analizuar dhe si do të sigurohet respektimi i interesit më të lartë të të miturit.

Parimi i mbrojtjes nga diskriminimi- sipas nenit 11 të KDPM të R.Shqipërisë, Të drejtat që burojnë nga ky Kod i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo të mituri në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzania, përkatësia prindërore, përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, vendbanimi, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje tjetër e të miturit, prindërve ose përfaqësuesve ligjorë të të mituri. Të drejtat për të miturin, të parashikuara në këtë Kod, mbrohen nga të gjitha format e diskriminimit për një nga shkaqet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 6

(1) Fëmijët viktimë të veprave që me ligj janë paraparë si vepra penale i kanë të drejtat e njëjta që i kanë edhe personat viktimë të moshës madhore, para, gjatë kohës dhe pas përfundimit të procedurës penale, si dhe të drejtat e veçanta të pranuar me Konventën për të drejtat e fëmijës dhe marrëveshjet tjera të ratifikuara.

(2) Fëmijët viktimë të veprave, të cilat me ligj janë paraparë si vepra penale dhe fëmijët dëshmitarë gëzojnë mbrojtje të përforcuar dhe përkrahje nga të gjitha institucionet, organet dhe individët në sistemin për drejtësi për fëmijë, me qëllim që të zvogëlohen pasojat negative mbi ta nga vepra penale dhe të pengohet ndikimi negativ i veprimit të

institucioneve mbi zhvillimin e drejtë të fëmijës dhe të nxiten të kërkojnë mbrojtje para gjykatës kompetente.

Neni 7

1. Fëmijës mbi moshën 14 vjet në veprimin joformal të organeve dhe shërbimeve kompetente, si dhe në procedurën gjyqësore, i garantohen të drejtat e njëjta që i kanë personat e moshës madhore të akuzuar në procedurë penale, ose kundërvajtëse, si dhe të drejtat e veçanta të pranuar me Konventën për të drejtat e fëmijës dhe marrëveshjet tjera të ratifikuara, në të gjitha fazat e procedurës dhe në shqiptimin dhe në kryerjen e cilitdo sanksioni ose mase të paraparë me këtë ligj.

2. Nuk mund të konsiderohet se fëmija bie ndesh me ligjin derisa kjo nuk përcaktohet me vendim të plotfuqishëm gjyqësor.

3. Gjatë veprimit të gjykatës dhe të institucioneve tjera në zbatimin e dispozitave të këtij ligji, qëllim kryesor e kanë realizimin e interesave më të mira për fëmijën.

Neni 8

1. Gjykata dhe institucionet tjera në zbatimin e këtij ligji i respektojnë dhe i sigurojnë të drejtat e fëmijës pa asnjë diskriminim, pa dallim të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, përkatësisë së grupit të marginalizuar, përkatësisë etnike, gjuhës, shtetësisë, origjinës sociale, religjionit ose besimit fetar, llojeve tjera të besimit, shkollimit, përkatësisë politike, statusit personal ose shoqëror, pengesave mentale dhe trupore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore ose çfarëdo qoftë tjetër përveç asaj që është paraparë me ligj ose marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare, të prindit/ëve, ose tutorit/ëve ose të anëtarëve të familjes së fëmijës.

2. Gjykata dhe institucionet tjera gjatë zbatimit të këtij ligji i ndërmarrin të gjithë masat e nevojshme për sigurimin e mbrojtjes së fëmijës nga të gjitha llojet e diskriminimit ose sanksionit ose kufizimeve tjera të të drejtave në bazat e parapara në paragrafin (1) të këtij ligji.

Lufta kundër delikuencës së të miturve, nuk mund të udhëhiqet në masë të njëjtë, dhe me mjete të njëjta sikurse edhe ndaj kryerësve të rritur të veprave penale si dhe llojet e saksioneve nuk mund të shqiptohen njësoj sikurse ndaj të rriturve. Ndaj kryerësve të mitur të veprave penale burgu për të mitur shqiptohet vetëm në rastet kur vepra penale është e rrezikshmërisë së lartë shoqërore dhe për shkak të rrethanave të kryerjes së veprës dhe cilësisë së kryerësit të veprës penale³³.

Burgu për të mitur mund t'i shqiptohet të miturit të rritur me përgjegjësi penale, nëse ka kryer vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me burg prej pesë viteve ose dënim më i rëndë dhe nëse vepra është kryer në rrethana veçanërisht rënduese me ç'rast nuk do të ishte e arsyeshme të shqiptohej masa edukative³⁴.

Neni 9

1. Asnjë fëmijë nuk guxon t'i ekspozohet mundimit ose veprimeve ose sanksioneve tjera mizore jonjerëzore ose nënçmuese.
2. Fëmija çdo herë ka të drejtë për mbrojtje të përforcuar nga mundimi dhe veprimet ose sanksionet tjera mizore jonjerëzore ose nënçmuese.

Neni 10

Privimi i fëmijës nga liria zbatohet vetëm si mjet i fundit në procedurë, dhe vetëm në kushte dhe në kohëzgjatje të përcaktuar me këtë ligj.

³³ Ismail Zejneli, Delikuenca e të miturve, Tetovë, 2018, fq.181

³⁴ Neni 44 i Ligjit mbi drejtësinë për të mitur, ("Gazeta zyrtare e RM-së", nr. 87/2007);

Gjatë peshimit të dënimit gjykata do t'i merrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë që dënimi të jetë më i madh ose më i vogël, posaçërisht duke pasur parasysh shkallën e zhvillimit shpirtëror të të miturit dhe kohën e nevojshme për edukim, riedukim dhe përgatitjen profesionale³⁵.

Neni 11

Çdo veprim në gjykatë dhe në institucione tjera me fëmijë në zbatimin e dispozitave të këtij ligji duhet të zgjasë dhe të përfundojë në afat të arsyeshëm, që nuk do t'i dëmtojë interesat e tij.

Neni 12

Fëmija, ose përfaqësuesi ligjor i tij, ka të drejtë informimi për rrjedhën e veprimit dhe të drejtën e ankesës dhe parashtresës për mbrojtjen e të drejtave, te Avokati i Popullit dhe organet dhe institucionet tjera të cilat kanë kompetencë që të kujdesen për të drejtat e fëmijës.

Neni 13

Zbatimi i masave dhe sanksioneve të përcaktuara me këtë ligj dhe veprimi me fëmijën janë paraparë në interes të tij për mbrojtje, edukim, riedukim dhe zhvillim të drejtë.

Neni 14

(1) Veprimi në gjykatë dhe në institucione tjera gjatë zbatimit dhe kryerjes së sanksioneve dhe masave tjera duhet t'i përshtatet moshës, personalitetit dhe nevojave dhe interesave të fëmijës.

(2) Gjatë zbatimit të masave në procedurat e përcaktuara me këtë ligj fëmijës mbi 14 vjet mund t'i merren ose kufizohen të drejta të caktuara vetëm në masë që i përgjigjet shkallës së arritur të zhvillimit dhe të personalitetit të tij dhe të nevojës së tij për mënjanimin e gjendjeve që ndikojnë ai të kryejë veprime që me ligj janë paraparë si vepra penale ose kundërvajtje.

³⁵ Vllado Kambovski, E drejta penale (përkthim në shqip) Shkup, 1996, fq.1113

Neni 15

Gjatë vendosjes për zbatimin e masave dhe sanksioneve të përcaktuara me këtë ligj, çdo herë u jepet përparësi masave preventive, mbrojtëse dhe edukuese.

Sipas disa të dhënave në Republikën e Maqedonisë reth 85% të veprave penale të kryera nga ana e të miturve janë vepra penale kundër pasurisë, 6% vepra penale kundër jetës dhe trupit, ndërsa 9% janë vepra tjera penale. Është interesant fakti se nga numri i përgjithshëm i veprave penale të kryera nga ana e të miturve, 7% i kanë kryer personat e mitur të gjinisë femërore, ndërkaq, 50% të këtyre veprave janë kryer nga ana e personave të mitur të organizuar në banda kriminale³⁶.

Neni 16

Masa ose sanksioni që i shqiptohet fëmijës mbi 14 vjet duhet t'i përgjigjet personalitetit të tij, peshës së veprimit që me ligj është paraparë si vepër penale ose kundërvajtje dhe pasojave të saj, nevojës për edukimin, riedukimin, arsimimin dhe zhvillimin e tij, për shkak të sigurimit të mbrojtjes së interesit që është më i volitshëm për fëmijën.

Neni 17

1. Për veprën e fëmijës mbi 14 vjet që me ligj është paraparë si vepër penale ose kundërvajtje, organet dhe institucionet kompetente sipas rregullës nuk ngritin procedurë gjyqësore, që të tejkalohet ndikimi i dëmshëm mbi fëmijën
2. Procedura gjyqësore sipas rregullës ngritet vetëm në rastet e parapara si vepër penale me këtë ligj, nëse fëmija mbi 14 vjet ka kryer vepër që është paraparë si vepër penale për të cilën shqiptohet dënim me burg prej tri vitesh ose dënim më i rëndë, ose në rastet kur qëllimi i masave ose sanksioneve të përcaktuara me këtë ligj nuk mund të arrihet pa procedurë të tillë.

³⁶ S. Aleksoski, Kriminalna psihologija, Shtip, 1997, fq.13

Neni 18

- (1) Procedurën ndaj fëmijës e mban dhe sanksionet e përcaktuara me këtë ligj i shqipton vetëm gjykata kompetente.
- (2) Masa tjera të parapara me këtë ligj mund të shqiptojnë edhe organet tjera të specializuara.

4. Domethënia e nocioneve dhe shprehjeve

Në procedurë ndaj të miturve për vepra penale dhe për kundravajtje, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe, përshtatëshmërisht zbatohen dispozitat e LPP-së dhe të Ligjit për kundravajtje sa u përket: parimeve themelore, gjuhës, kompetencës territoriale, pasojës së jokompetencës dhe konfliktit të kompetencës, përjashtimit, të pandehurit, mbrojtësit, shkresave, procesverbaleve, rivendosjes së afatit, shpenzimeve, kërkesës pronësore juridike, marrjes dhe komunikimit të vendimeve, dorëzimit të shkresave, thirrjes, shoqërimit, ndaljes së personit, dorëzimit dhe marrjes së lejes së udhëtimit nga i huaji, marrjes në pyetje të dëshmitarëve, këqyrjes, ekspertimit, kontrollit të lokaleve dhe personave, mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike³⁷.

3.1.Përparësitë dhe mangësitë në krahasim me ligjin paraprak për fëmijë në RMV

Ligji për të drejtat e fëmijëve i vitit 2007 kishte qasje restriktive dhe retributive në procesin e delikuencës së të miturve. Që të tejkalohet modeli i vjetër në sistemin e delikuencës së të miturve ishte e patjetërsueshme krijimi i reformave me të cilën do të nxjeren fëmijët të cilët janë ndeshur me ligjin në theks të veçantë në tretmanin penalo-juridik e rregulluar sipas Kodit Penal, ashtuqë do të formohet sistemi institucional juridik i cili plotësisht do të përshtatet me normat dhe standardet ndërkombëtare të cilat janë të përfshira në Konventa për të drejtat e fëmijëve në Kombet e Bashkuara e vitit 1989 dhe në dokumentet tjera ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve, e gjithë kjo është arritur me sjelljen e ligjit të ri, Ligji për të drejtat e fëmijëve në vitin 2013.

³⁷ Neni 79 i LDMM

Rol të rëndësishëm kishte dhe sjellja paraprake e Ligjit të procedurës penale të vitit 2010. Ligji për të drejtat e fëmijëve mundësoi krijimin e një sistemi institucional juridik për të drejtat e të miturve dhe qëllimet që duhet të arihen përmes mekanizmave-institucioneve shtetërore, Ligji për të drejtat e të miturve është kodeks i dispozitave materiale procesuale dhe ekzekutive të cilët kanë të bëjnë me fëmijët që janë në rrezik, fëmijët që ndeshen me ligjin dhe personat e ritur. Gjithashtu, ligji për të drejtat e fëmijëve i udhëzon institucionet të cilat janë të kyçura në kujdesin, mbrojtjen dhe dënimet e fëmijëve në procedura të ndryshme dhe masa për dënime të parashikuara në ligje tjera si ligji mbi familjen, ligji për arsimim, etj.

Regullimi i parandalimit dhe mbrojtjes të fëmijëve dhe veprave penale përmban aktivitete të pa definuara ligjërisht, organe të ndryshme shoqërore në të cilat janë krijuar mënyra standarde për procesimin me masa preventive dhe masa tjera ndaj fëmijëve.

Fëmijët janë kategori e posaçme dhe specifike duke u nisur nga aspekti i gjendjes së tyre psikofizike ata ende nuk janë personalitete të pjekura nga njëra anë e nga ana tjetër mekanizmat për mbrojtjen dhe risocializimin e fëmijëve sipas ligjit për të drejtat e fëmijëve janë të detyruar të japin ndihmë dhe mbrojtje me detyrimet e veçanta të Qendrave për punë sociale por edhe të gjitha institucionet arsimore dhe këshilluese të cilët kanë rol të rëndësishëm në këtë proces.

Rol të rëndësishëm kanë edhe qendrat për realizimn e masave këshilluese dhe dënimeve ku fëmijët në maksimum duhet të mbrohen nga ndikimet negative, duku u krijuar kushte më të mira gjatë procesit të risocializimit të tyre, për këtë qëllim rol të rëndësishëm kanë edhe këshillat preventive të delikuncës së të miturve.

Në këtë kontekst të gjitha institucionet dhe të punësuarit në këto institucione janë kompetent për zbatimin e ligjit për të drejtat e fëmijëve të cilët duhet të jenë të specializuar në këtë drejtim pasi kemi të bëjmë me një kategori te veçantë siç janë fëmijët.

Gjithashtu, është krijuar edhe korniza ligjore për tretmanin e fëmijëve në pajtim me normat dhe standardet ndërkombëtare me të vetmin qëllim që të mbrohen dhe respektohen në tërësi të drejtat e tyre.

Ligji për të drejtat e fëmijëve ka për qëllim krijimin e shëndoshë në çdo pikëpamje me dhënien e prioritetit të interesave të fëmijëve a përmes idesë së drejtësisë, mbrojtjes individuale dhe preventive si qëllim i sistemit të masave për ndihmë si dhe garancion për respektimin e të drejtave të fëmijëve.

Me ligjin e ri për të drejtat e fëmijëve janë të përfshira edhe dispozitat e konventave ndërkombëtare të ratifikuara në RVM të cilat janë të implementura në të drejtën tonë nacionale.

Fëmijët, si kategori janë të ndarë plotësisht nga personat e rritur dhe kanë kujdes të veçantë nga shteti në lidhje me problemet e tyre, gjithashtu fëmijët janë të ndarë edhe nga regjimi juridiko penal për të rriturit, po ashtu zhvillohet ideja për socializimin, rehabilitimin dhe mbrojtjen e fëmijëve si kryerës të veprave penale a sistemi i sanksioneve lirohet nga ideja retributive përmes tretmanit individual për secilin fëmijë.

Sanksionet alternative mbesin forma e regullt e sanksioneve, forcohen proceset veçanërisht garancioni, procedura të shpeshtuara joformale mediacioni.

Tretmani institucional është i përcaktuar në standardet gjegjësisht norma universale të repta, a tretmani jashtë institucional mundëson marje pjesë të organeve shoqërore dhe të ndryshme.

Ligji i mëparshëm për të miturit i ndan të miturit në tri kategori:

1. fëmijët nën 14 vjet

2. të miturit të ri të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale i kanë mbushur 14 vjet po nuk i kanë mbushur 16 vjet

3. të mitur të vjetër të cilët në momentin e kryerjes së veprës penali i kanë mbushur 16 vjet por nuk i kanë mbushur 18 vjet, ndarje e cila nuk ishte në përputhje me norma ndërkombëtare.

Kjo ndarje kishte tretman të ndryshëm në aspektin e sistemit të sanksioneve.

Në ligjin për të drejtat e të miturve masat edukative ndaj tyre ishin të parashikuara si sanksione themelore a kishin të bëjnë në mbrojtje, ndihmë, mbikëqyrje dhe në aftësimin profesional dhe zhvillimin e përgjegjësisë penale të të miturve me qëllim të risocializimit dhe

zhvillimit të rregullt të cilat sipas ligjit për të drejtat e të miturve janë të sistematizuara në tre kategori:

Masa diciplinore për mbikëqyrje të shtuar dhe masa të shtuara.

Për dallim nga ky ligj, ligji për të drejtat e fëmijëve është kodeks i vogël për të drejtat e fëmijëve dhe përfshin 5-kategori:

1. Fëmijë të cilët ndeshen me ligjin-delikuentët
2. fëmijë në rezik
3. kryerës të mitur të ri
4. fëmijë viktimë të veprave penale nga dhuna
5. fëmijë dëshmitarë në procedurën penale

Secila nga këto kategori ka status të veçantë dhe të drejtën e pjesmarjes në procedura nga aspekte të ndryshme. Duke marrë parasysh se fëmija mund të ketë pozicione të ndryshme, cilësi të ndryshme si i dyshuar si i dëmtuar dhe si dëshmitarë. Ekzistojnë dispozita juridike materiale dhe procesuale, me të cilat rregullohet statusi dhe kompetenca e organeve të posaçme si Qendra për punë sociale, Policia, Prokuroria, Gjykatësi për fëmijë, prindërit dhe subjektet e tjera.

Uniteti i brendshëm i këtyre dispozitave të ndryshme i siguron qëllimet dhe parimet të pjesmarësve në procedura të ndryshme ndaj fëmijëve të cilët kanë për qëllim risocializimin e tyre. Kjo do të thotë se ligji për të drejtat e fëmijëve është në lidhshmëri me ligjet tjera, risi është neni 88 i këtij ligji në veçanti alinea 2.

Neni 88 paragrafi (1) Fëmija që ngarkohet me veprim që me ligj është paraparë si vepër penale ose kundërvajtje, ka të drejtë për gjykim të drejtë në afat të arsyeshëm, para gjykatës së pavarur e të paanshme të themeluar me ligj, me të gjitha garancitë për të drejtat që i ka i akuzuari në procedurë penale ose kundërvajtëse sipas Ligjit për procedurë penale, Ligjit për kundërvajtje dhe këtij ligji.

(2) Procedura ndaj fëmijëve është urgjente kur bëhet fjalë për veprim që me ligj është paraparë si vepër penale dhe sipas rregullës nuk mund të zgjasë më shumë se një vit nga dita e pranimit të

lëndës në gjykatë deri në miratimin e vendimit të shkallës së parë, përveç veprimeve që me ligj janë paraparë si vepra penale për të cilat është përcaktuar dënim me burg prej së paku katër vitesh, kur procedura nuk mund të zgjasë më shumë se një vit e gjashtë muaj, ose kur bëhet fjalë për veprim që me ligj është paraparë si kundërvajtje, jo më gjatë se nëntë muaj.

(3) Kur fëmija nuk është i kapshëm, gjykata miraton aktvendim për ndërprerjen e procedurës. Në këtë rast afatet nga paragrafi (2) i këtij neni pushojnë të rrjedhin për kohën që ka qenë i pakapshëm, por jo më gjatë se deri në mbushjen e moshës 27 vjet të kryerësit.

(4) Procedura ndërpritet me detyrë zyrtare.

Republika e Maqedonisë së Veriut është shtet i cili plotësisht është i përkushtuar ndaj reformave në të mirën e fëmijëve dhe ndryshimet tjera për të drejtat me të vetmin qëllim mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave themelore lirive, risocializimin dhe integrimin e tyre në shtet dhe në shoqëri si qytetarë të ardhshëm të përgjegjshëm³⁸.

Qendra për punë Sociale ka rol të rëndësishëm dhe vlefshëm në planin për zbatimin e masave për mbrojtje dhe ndihmë të fëmijëve. Për këtë qëllim Qendra për punë Sociale formon reparte të specializuara dhe ekipe profesionale për fëmijë.

Të punësuarit në Qendër për punë Sociale kryejnë trajnime të specializuara brenda dhe jashtë shtetit. Me këtë shkëmbehen përvoja dhe tejkalohe dilemat e implemetimit të Ligjit për të drejtat e fëmijëve dhe njëkohësisht unifikohet praktika dhe veprimi ndaj fëmijëve.

³⁸ Marë nga komenti i Ligjit për të drejtat e fëmijëve, Shkup 2018

KAPITULLI I IV-të

4.1. Mbikëqyrja dhe roli i Qendrës për Punë sociale

Qendra për Punë sociale në Tetovë është ent publik me kompetenca publike me qëllim të kryerjes dhe realizimit të veprimtarive nga fusha e mbrojtjes sociale dhe punëve sociale si dhe kryen punë tjera të përcaktuara me Ligj.

Masën mbikëqyrja e shtuar nga ana e Qendres për punë sociale, Gjykata e shqipton në raste kur prindërit, adoptuesit apo kujdestari nuk janë në gjendje të zbatojnë kontrollin e shtruar ndaj të miturit.

Me vete faktin se i mituri gjendet apo jeton me prindërit e tij, është më se e nevojshme që organi social të jetë në kontakt edhe me prindërit e të miturit në dhënien e udhëzimeve, për punë të mëtejshme me të miturin, në drejtim që të japë përkrahje, rezultateve që ka realizuar personi zyrtar.

Me vonë këta persona janë të detyruar nga ana e tyre ta informojnë personin zyrtar kompetent për zbatimin e masës për rrethanat dhe pengesat, që kanë ndikim negativ në realizimin e saj. Për të gjitha rrethanat në zbatimin e kësaj mase, vetëm personi zyrtar është i obliguar rregullisht ta informoj Gjykatën kompetente, e cila varësisht nga rezultatet e arritura mund ta ndërpresë zbatimin e mëtejshëm të saj apo këtë masë ta zëvendësojë me masë tjetër.

Nëse prindërit, adoptuesi apo kujdestari nuk kanë mundësi që të miturin ta dorëzojnë në familje tjetër me qëllim të mbikëqyrjes së shtuar i mituri do të qëndroje nën mbikëqyrje të organit social.

Qendrat për punë sociale në kuadër të kompetencave të punës së tyre bëjnë pjesë në kuadër të sektorit të mbrojtjes sociale pranë Ministrisë për punë dhe Politikë Sociale. Në përputhje me rregullat ligjore, Qendrat për punë dhe politikë sociale funksionojnë si ente

profesionale me autorizime publike me qëllim të kryerjes së punëve nga fusha e mbrojtjes sociale³⁹.

4.2 .Avokati i Popullit si mbrojtës i të Drejtave të Fëmijëve

Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë, krahas të drejtave elementare të qytetarëve, është kompetent të sigurojë mbrojtje të veçantë të të drejtave të fëmijëve, për të cilin qëllim, sipas obligimit të përcaktuar ligjor, në kuadër të institucionit Avokati i Popullit është formuar departament i veçantë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Në pjesën e drejtësisë për fëmijë, Avokati i popullit, respektivisht Departamenti i lartpërmendur, i kushton kujdes të veçantë respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në rrezik para institucioneve shtetërore dhe organizatave të tjera të cilat kryejnë autorizime publike, si në drejtim të masave preventive ashtu edhe në drejtim të masave për mbrojtjen dhe rehabilitimin e fëmijëve në rrezik dhe fëmijëve viktima, për shkak të shkeljes së të drejtave të fëmijëve, parashtresa deri tek ky organ kanë të drejtë të parashtrojnë fëmiu dhe përfaqësuesi i tij ligjor, respektivisht kujdestari, si dhe ç'do person tjetër, organ apo organizatë të cilët kanë njohuri se është cënuar e drejtë e caktuar e fëmijut⁴⁰. Poashtu, ky organ është kompetent që të inicojë procedurë për mbrojtje të të drejtave të fëmijëve me vetë iniciativë, nëse vlerëson se organet apo organizatat para të cilëve është i autorizuar të veprojë i cënojnë të drejtat e fëmijëve me ndërmarrje apo mosndërmarrje të ndonjë veprimi të caktuar; si dhe të ndjekë gjendjen e realizimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, pra edhe të kategorisë së fëmijëve të përfshirë me Ligjin për drejtësinë e fëmijëve⁴¹.

Në përbërje të Këshillit Shtetëror për parandalim të delikuencës së fëmijëve, përveç 15 anëtarëve të cilët zgjidhen nga ana e Kuvendit, merr pjesë dhe një përfaqësues nga Avokati i Popullit⁴².

³⁹ Centar za socialna rabota-mtsp.gov.mk

⁴⁰ INFORMATOR për subjektet të cilët punojnë në sistemin e drejtësisë për të mitur, 2013, fq.40

⁴¹ Po aty

⁴² Neni 154, p.6 i LDF

Avokati i Popullit bashkëpunon me Këshillin në drejtim të parandalimit të delikuencës së fëmijëve. Poashtu raporton për punën e tij në këtë drejtim, respektivisht në Raportin vjetor të punës së Këshillit janë potencuar edhe aktivitetet e Repartit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe personave me nevoja të veçanta në kuadër të Avokatit të Popullit. Avokati i popullit si ç’do vit edhe në 2015-tën vazhdoi ta përcjellë gjendjen me sigurimin e lirive dhe të drejtave të barabarta për të gjithë fëmijët, mundësimin e një jete dinjitoze dhe respektimin e fëmiut si bartës të këtyre të drejtave.

Megjithatë, konstatoi se në praktikë realizimi i të drejtave të fëmijëve dhe respektimi i tyre ende nuk ishte në nivel të kënaqshëm⁴³.

Ky organ viziton sistematikisht, si dhe në vitin e fundit të hulumtimit Entet shtetërore në të cilat janë të vendosur fëmijë në rrezik, ku dhe kishte konstatuar se edhe në vitin 2015 këto ente nuk kishin arritur plotësisht që të i’u ndihmojnë këtyre fëmijëve për përmirësimin e sjelljes së tyre dhe zhvillimit të drejtë. Gjatë vizitave të enteve u konstatua se fëmijët shpesh janë në ikje, kurse personeli nuk ka mundësi ti plotësojnë qëllimet e planifikuara me planet individuale dhe programet për punë. Për këtë shkak, në vend të përmirësimit të sjelljes së fëmijëve dhe kthimit eventual në familjet e tyre, një pjesë e fëmijëve të vendosur në qendrën “25 Maj”-Shkup, dërgohen në qendrën “Ranka Milanoviq”-Shkup, për shkak të sjelljes destruktive të tyre. Është shqetësues edhe konstatimi se shpesh fëmijët të cilët takohen gjatë vizitave në Shtëpinë edukuese-përmirësuese –Tetovë, Veles paraprakisht kanë kaluar në këto Qendra!

Avokati i popullit ju rekomandon organeve dhe institucioneve kompetente ndërmarrjen e masave urgjente dhe aktiviteteve për tejkalim të situatës së lartëpërmendur, me qëllim të realizimit të të drejtave të fëmijëve të vendosur nëpër entet e ndryshme.

⁴³ Raporti për 2015 i Këshillit SHPDF, 2016

4.3. Organizatat joqeveritare të cilat kanë realizuar bashkëpunim me Këshillin Shtetëror për parandalimin e delikuencës së fëmijëve

Organizatat joqeveritare të cilat kanë realizuar bashkëpunim me Këshillin Shtetëror për parandalimin e delikuencës së fëmijëve në Republikën e Maqedonisë janë të themeluara numër i madh i organizatave joqeveritare, të cilat shumica veprojnë në sferën e mbrojtjes së fëmijëve dhe të drejtave të tyre.

Ato mund të kenë rol plotësues me institucionet tjera publike dhe shtetërore në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, por, poashtu paraqiten edhe si korigjuese, ose si organizata të cilat ofrojnë shërbime plotësuese dhe ndihmë në raste kur nuk ekzistojnë institucione publike të specializuara për qëllime të caktuara. Organizatat joqeveritare ofrojnë shërbime të ndryshme, mes tjerash: Ndihmë dhe mbrojtje direkte fëmijëve; Ngritjen e vetëdijes publike për të drejtat e fëmijëve; Lobim dhe përfaqësim për ndryshime dhe plotësime të rregullativës ligjore; Trajnime të personave nga sektori publik dhe privat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, ndërtim të kapaciteteve dhe sigurim të përkrahjes tjetër publike⁴⁴.

Në listën e “Informatorit për subjektet të cilët punojnë në sistemin e drejtësisë për të mitur”, të publikuar nga Këshilli Shtetëror për parandalimin e delikuencës së fëmijëve (Prill, 2013), janë të evidentuara gjithsej 44 organizata joqeveritare të cilat veprojnë në sferën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Po përmendim disa nga ato, si: Asociacioni për mbështetje të fëmijëve dhe familjeve në rrezik; Asociacioni për promovim të shëndetit mental dhe parandalim të keqpërdorimit të fëmijëve “Fëmijëri e sigurtë”; Ambasada e parë botërore e fëmijëve “Megjashi”- R.M.; Shpëtoni fëmijët; Komiteti i Helsinkut për të drejtat e njeriut i R.M.; Asociacioni i qytetarëve SOS “Fshati i fëmijëve”; Asociacioni për të drejtat e fëmijëve – Qendra ditore për fëmijët në rrugë etj.

Në vazhdim, do të paraqesim veprimtarinë e dy organizatave joveritare të cilat kanë realizuar bashkëpunim me Këshillin gjatë vitit 2015, dhe ato janë: “SOS Fshati i fëmijëve”, dhe “Asociacioni për të drejtat e fëmijut”.

⁴⁴ INFORMATOR për subjektet të cilët punojnë në sistemin e drejtësisë për të mitur, 2013, fq.55

☒ **“SOS Fshati i fëmijëve”**: Programi preventiv në kuadër të kësaj organizate joqeveritare funksionon nga viti 2007, në dy lokacione në qytetin e Shkupit, përmes dy Këshillimoreve-qendra për fëmijë dhe prindër. Grupi target i tyre janë familjet me fëmijë të mitur, ku fëmijët janë në rrezik për ta humbur kujdesin e prindërve/kujdestarëve, për shkak të prezencës së një apo më shumë gjendjeve të rrezikut social me të cilat ballafaqohen familjet. Prej themelimit e deri në nëntor të vitit 2015, përmes këtyre dy Qendrave këshilldhënëse janë përkrahur gjithsej 746 fëmijë nga 215 familje, me 260 prindër/kujdestarë. Nga ky numër 41 familje me 180 fëmijë bëjnë pjesë në kategorinë e fëmijëve të rrugës. Në të dy Qendrat përmes ndihmës me këshillëdhënie dhe punëtorive ofrohet mbështetje arsimore, psiko-sociale dhe shëndetësore për fëmijët, mbështetje për prindërit, edukim për zhvillim të hershëm të fëmijëve, mbështetje për sigurim të qëndrueshmërisë ekonomike të familjeve dhe ndërtim të kapaciteteve të prindërve⁴⁵.

☒ **“OJQ Asociacioni për të drejtat e fëmijut”**: Kjo organizatë joveritare e zhvillon “

Qendrën ditore edukative dhe zbavitëse për fëmijët në rrugë” në Shuto Orizari, e cila qendër është e themeluar nga viti 2007 dhe deri më sot ajo ofron ndihmë dhe mbrojtje për fëmijët dhe familjet e tyre. Qendra ditore për fëmijë punon me grupe të fëmijëve në rrugë nga bashkësia rome, në komunën e cekur më lartë. Këto janë fëmijë nga familje sociale rome me shumë fëmijë, të moshave 4-17 vjeçarë, të cilët nuk janë të kyçur në sistemin edukativo-arsimor, dhe kohën më të madhe e kalojnë rrugëve, të kyçur në lypsari apo duke jetuar në kushte të pavolitshme banesore dhe materiale⁴⁶.

Bëhet fjalë për preventivë primare, me ç’rast në Qendër adresohen shkaqet apo faktorët kryesorë ende para se fëmijët të bëhen pjesë e sistemit të delikuencës së fëmijëve, me qëllim që të sigurohet një mjedis i sigurtë për të gjithë fëmijët. Në këtë Qendër Ditore mundësohen nevoja të ndryshme për fëmijët, si: Mbajtja e higjienës personale, ndjekja e fëmijëve në aspektin shëndetësor, bashkëpunim me institucionet shëndetësore për sigurimin e

⁴⁵ Raporti për 2015 i Këshillit SHPDF, 2016, fq.46

⁴⁶ Raporti për 2015 i Këshillit SHPDF, 2016, fq.47

mbrojtjes shëndetësore të fëmijëve, imunizim dhe edukim shëndetësor për fëmijët, mbathje, ushqim, angazhim në aktivitete të dobishme.

Qëllimi kryesor i programit të punës së Qendrës ditore për fëmijët e rrugës është integrimi social dhe ndërprerja e ciklit të marginalizimit të tyre, respektivisht largimi i tyre nga rruga dhe kyçja në rrjedhat e rregullta të jetës. Kjo Qendër tashmë dhjetë vite ofron mbështetje të gjatë për përmirësimin e shkallës së regjistrimit, ndjekjes dhe mbarimit të sistemit edukativo-arsimor për kategorinë e fëmijëve në fjalë. Gjatë vitit 2015, Qendrën ditore e kanë vizituar 218 fëmijë, 143 fëmijë, nga të cilët në vitin akademik 2014/15 shkollën e kanë vijuar 84 dhe 81 e kanë mbaruar atë me sukses⁴⁷.

4.4.Shkeljet e të drejtave të fëmijëve-viktimë në Maqedoni

Viktima paraqet çdo person fizik, i cili ka pësuar ndonjë ligësi, përfshirë edhe çrregullim psikik dhe mendor, vuajtje emocionale ose humbje parash, të shkaktuara nga kryerja ose moskryerja (lëshimi), me çka shkelet ligji juridiko-penal i shtetit anëtar. Aty ku është e mundshme, termi viktimë i përfshin, edhe anëtarët më të ngushtë të familjes së viktimës, të cilët janë në varësi nga viktima në fjalë.

Fëmijë viktima dhe dëshmitarë nënkupton fëmijë dhe adoleshentë në moshën 18 vjeçare, të cilët janë viktima ose dëshmitarë të krimit, pavarësisht nga roli i tyre në kundërvajtje ose në përndjekjen e shkelësit të pretenduar ose grupit të shkelësve (autorëve të veprës).

Republika e Maqedonisë e ka ratifikuar Konventën për të drejtat e fëmijës, me çka e ka marrë përsipër detyrimin e përkujdesjes për realizimin e saj, gjegjësisht detyrimin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe avancimin e gjendjes së tyre. Mirëpo, ky nuk është vetëm detyrim i shtetit, por edhe detyrim i individëve, të cilët përmes veprimeve të përditshme mund të dëshmojnë se i pranojnë dhe respektojnë të drejtat e fëmijëve.

Konventa për të drejtat e fëmijës në nenin 39 përcakton detyrime se shteti i ndërmerr të gjitha masat përkatëse për rimëkëmbje më të mirë fizike dhe psikike për reintegrim social të

⁴⁷ Po aty, fq.48

fëmijës viktimë të ndonjë forme të shpërfilljes; eksploatimit; keqpërdorimit; torturës ose ndonjë forme të veprimit mizor, johuman ose degraduese; dënimit dhe përlleshjes së armatosur.

Rimëkëmbja dhe reintegrimi zhvillohet në mjedise, të cilat e stimulojnë shëndetin, vetërespektin dhe dinjitetin e fëmijës. Të gjitha format e dhunës, abuzimit ose shpërfilljes me të cilat kanoset ose çënohet integriteti fizik dhe psikik i fëmijës paraqesin shkelje të njërës ndër të drejtave themelore të njeriut, të cilat Konventa i ka ngritur në nivel të principeve gjegjësisht parimeve, siç janë e drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit. Këta procedura janë hartuar edhe për shkak se sot një numër i madh i fëmijëve vuajnë si rezultat i krimit ose keqpërdorimit të pushtetit (fuqisë), për shkak se të drejtat e këtyre fëmijëve nuk janë të pranuar si duhet, për shkak se fëmijët mund të ekspozohen në vështirësi plotësuese, kur janë në cilësinë e ndihmuesit të procesit juridik, aq më shumë pasi janë vulnerabil dhe kanë nevojë për mbrojtje të posaçme në përputhje me moshën e tyre, nivelin e pjekurisë dhe nevojat e posaçme individuale, me çka edhe do të pengohet viktimizimi i fëmijëve.

Është e pakontestueshme se pjesëmarrja e fëmijëve-viktima nga dhuna ose nga veprat penale në procedurat e gjyqësisë është me rëndësi qenësore për procesimin efikas të akuzave për vepra penale, duke përfshirë edhe rastet e eksploatimit seksual të fëmijëve, tregtisë me fëmijë dhe forma tjera të krimit të organizuar transnacional, ku fëmijët janë shpeshherë dëshmitarët e vetëm. Është fakt që fëmijët-viktima të dhunës ose të veprave penale kanë nevojë për mbrojtje të posaçme, për asistencë dhe mbështetje e cila përputhet me moshën e tyre, pjekurinë dhe nevojat e posaçme individuale, me qëllim që të pengohet viktimizimi i mëtejshëm si rezultat i pjesëmarrjes në procesin e gjyqësisë penale. Meqenëse është imperativ detyrimi për specializim të procedurave, të cilat praktikohen për vepra penale, në të cilat fëmijët janë viktima të dhunës ose të veprave penale, organet kompetente mund të veprojnë vetëm nëse posedojnë arsim adekuat, dituri të posaçme dhe përvoja në sferën e së drejtë së fëmijës dhe mbrojtjes juridiko-penale të fëmijëve-viktima. Standardet ndërkombëtare përcaktojnë kufi të caktuara minimale, të cilat duhet të hasen në çdo legjislacion nacional, me qëllim që të garantohet mbrojtja e fëmijëve viktima të dhunës ose të veprave penale. Në këtë kontekst standardet parashohin që:

- Marrjen në pyetje dhe format tjera të hulumtimit duhet t'i zbatojnë profesionistë të trajnuar, të cilët sillen me respekt ndaj fëmijës .
- Të gjitha kontaktet me fëmijën duhet të bëhen në mjedis adekuat, që do t'i përmbush nevojat e posaçme të fëmijës dhe në gjuhën që e kupton dhe e flet fëmija, me qëllim që të ketë mundësi më të volitshme për pjesëmarrje (bashkëpunim) nga vetë fëmija,
- Fëmijët viktimë dhe dëshmitarë, prindërit ose tutorët e tyre, nga kontakti i parë me sistemin juridik duhet të informohen me kohë dhe në mënyrë adekuate për të drejtat e tyre,
 - Duhet të përcaktohen masa për të kufizuar kontaktet e panevojshme ndërmjet fëmijës dhe sistemit juridik, siç është kufizimi i numrit të intervistave të fëmijës (marrjes në pyetje) dhe përdorimi i video xhirimit si dëshmi,
 - Fëmijët viktimë të kenë të drejtë për ndihmë juridik, siç është përcaktuar në legjislacionin nacional për reintegrim të plotë dhe rimëkëmbje.
 - Fëmijët viktimë duhet të kenë qasje në shërbime për ndihmë dhe mbështetje, siç janë shërbimet financiare, juridike, këshillëdhënëse, shëndetësore, sociale dhe arsimore, shërbimet për rimëkëmbje fizike dhe fiziologjike dhe të gjitha shërbimet tjera të nevojshme për reintegrim të fëmijëve përmes organizatave qeveritare, vullnetare dhe organizatave tjera)
 - Duhet të nxitet formimi, fuqizimi dhe zgjerimi i fondeve nacionale për kompensim të viktimave.

Qëllimet themelore të procedurave dhe roli i tyre

Procedurat janë hartuar me qëllim që të respektohen parimet themelore nga të cilat burojnë të gjithë nenet e Konventës për të drejtat e fëmijës: mosdiskriminim; interesat më të mira të fëmijës; e drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit; e drejta e pjesëmarrjes (participimi në marrjen e të gjitha vendimeve, të cilat kanë rëndësi për të).

Procedurat kanë të bëjnë me të gjithë fëmijët-viktima pa diskriminim, gjegjësisht dhe pavarësisht statusit familjar, prejardhja etnike, statusi juridiko-penale dhe cilado formë e

karakteristikave sociale ose individuale (raca, ngjyra e lëkurës, gjinia, gjuha, besimi, nacionaliteti, specifikat mendore ose fizike të fëmijës së mitur dhe familjes së tij ose anëtarëve të familjes). Miratimi i procedurave duhet të kontribuojë në sigurimin e mbrojtjes së integritetit dhe interesave më të mira të fëmijës.

Procedurat duhet të kontribuojnë në afirmimin e të drejtave të fëmijëve, (dhënien e të gjitha informacioneve të nevojshme), shprehjen e opinionit personal në të gjitha procedurat, të cilat kanë të bëjnë me të, t'i përputhen moshës së tij dhe ta kuptojnë gjendjen, në të cilën janë ata.

Procedurat promovojnë krijim të mjedisit të posaçëm për bisedë me fëmijët-viktima, gjegjësisht hapësirat e posaçme për zhvillim të intervistës –bisedës me fëmijën-viktimë përmes përdorimit të mjeteve moderne audio-vizuele, gjegjësisht mjeteve teknike për komunikim. Pra synohet që procedurat të paraqesin një udhëzues gjithëpërfshirës me udhëzime për profesione të ndryshme ose institucione në sferën e “drejtësisë për fëmijë”, por edhe të përmirësohet kompetenca e profesionistëve, të cilët veprojnë me fëmijët viktima dhe të rritet ndjeshmëria e këtyre profesionistëve. Këto procedura janë të para në serinë e udhëzimeve dhe dokumenteve për fëmijët viktima dhe kanë për qëllim të përcaktojnë standarde të praktikës, me çka në masë të konsiderueshme do të përmirësohet cilësia e shërbimeve për fëmijët viktima dhe njëkohësisht do të merren si shkallë për çdo organizatë ose person, të përfshirë në sistemin “drejtësi për fëmijë”.

Këto procedura duhet të mundësojnë:

- të kontribuohet në avancimin e mirëqenies së fëmijëve përmes luftimit të dhunës dhe të zvogëlohet efekti i viktimizimit sekondar në procedurën penale;
- të kontribuohet në sigurimin e të gjitha masave, veprimeve, aktiviteteve dhe veprimeve të ndërmarra gjatë procedurës penale, që të jenë në interes më të mirë të fëmijës;
- të mundësohet krijimi i procedurave efikase dhe të vetme, të cilat do të sigurojnë procedurë të vazhdueshme dhe të koordinuar, e cila do t'i mbrojë fëmijët-viktima nga viktimizimi i mëtejshëm dhe do të sigurojë ndihmë adekuate;

- të kontribuohet në realizmin e rrjedhës efikase të informacioneve ndërmjet njësive organizative të ministrive dhe organeve tjera shtetërore dhe shërbimeve të përfshira në procesin e mbrojtjes së fëmijëve-viktima.
- të njihen dhe formohen njohuritë e profesionistëve për rregulloren e përgjithshme nacionale dhe ndërkombëtare për fëmijë, të cilët paraqiten si viktima të dhunës ose të veprave penale,
- të theksohen masat e ndihmës dhe mbrojtjes, të cilat mund të shfrytëzohen në çdo fazë të procedurës, me qëllim të zvogëlimit ose eliminimit të efekteve të dëmshme të dhunës ose të veprës penale ndaj fëmijës-viktimë dhe të merren informacione për masën më adekuate, të cilën duhet ta zbatoni, me çka do të arrini rezultate më të mirë me kufizim më të vogël ose suspendim të të drejtave të interesit të fëmijës.
- t’iu ndihmohen dhe orientohen fëmijët, në lidhje me të drejtat e fëmijëve-viktima të dhunës ose veprës penale, e në veçanti për të drejtat e tyre në procedurën e dëmshpërblimit,
- të zbatohen metoda dhe teknika të bisedës me fëmijën-viktimë të cilat janë më adekuate në procedurën e zhvillimit të intervistës-bisedës me fëmijën-viktimë të dhunës ose veprës penale, me qëllim që të shmanget viktimizimi i mëtejshëm ose shtrembërimi i ngjarjes, që do të shpinte në përjetimin më të rëndë të vetë ngjarjes,
- të njoftohen (profesionistët) me teknikat më të mira për ngjarjen juridiko penale, të cilën e ka përjetuar fëmija, ashtu që qysh gjatë zhvillimit të intervistës së parë të arrijnë ta fusin (rastin) në “karantinë” si dhe të marrin sa më shumë informacione,
- të promovohet krijimi i një mjedisi të posaçëm për bisedë me fëmijë-viktima, gjegjësisht hapësira të posaçme për intervistë-bisedë me fëmijën-viktimë përmes përdorimit të mjeteve moderne audio-vizuale, gjegjësisht mjeteve teknike për komunikim.

Rol të veçantë ka edhe Kodi penal

Kodi penal - Me nocionin viktimë të veprës penale nënkuptohet çdo person, i cili ka pësuar dëm, përfshirë dëmtim fizik dhe mendor, vuajtje emocionale, humbje materiale ose dëmtim dhe kanosje tjetër të të drejtave dhe lirive themelore të tij si pasojë e kryerjes së veprës penale. Me nocionin fëmijë viktimë të veprës penale nënkuptohet personi i mitur deri në 18 vjeç.

Ligji për procedurë penale- Të drejtat e viktimës neni 53 i Ligjit për Procedurë Penale (LPP), Viktima e veprës penale i ka të drejtat në vijim:

- 1) të marrë pjesë në procedurë penale si i dëmtuar me përfshirje në ndjekje penale ose për mënjanimin e kërkesës për dëmin juridiko-pronësor;
- 2) në kujdes dhe vëmendje të veçantë nga ana e organeve dhe subjekteve të cilët marrin pjesë në procedurën penale dhe
- 3) ndihmë efikase psikologjike dhe ndihmë tjetër profesionale dhe mbështetje nga ana e organeve, institucioneve dhe organizatave për ndihmë viktimave për vepra penale.

Policia, Prokurori publik dhe Gjykata veprojnë me kujdes të veçantë ndaj viktimave të veprave penale, duke u dhënë këshilla nga paragrafi (1) të këtij neni dhe nenet 54 dhe 55 të këtij ligji dhe kujdeset për interesat e tyre gjatë miratimit të vendimeve për ndjekje penale kundër të akuzuarit, përkatësisht gjatë marrjes së veprimeve në procedurën penale në të cilën viktima doemos duhet personalisht të marrë pjesë, për çfarë hartohet një shënim zyrtar ose procesverbal.

Në pajtim me rregullat e veçanta, viktima e veprës penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg prej së paku katër vitesh ka të drejtë për:

- 1) këshilltar në llogari të mjeteve buxhetore para dhënies së dëshmisë, përkatësisht deklaratës ose parashtrimin të kërkesës për të drejtën juridikopronësore, nëse ka lëndime të rënda psikofizike ose pasoja më të rënda nga vepra penale dhe

2) kompensim të dëmit material dhe jomaterial nga fondi shtetëror në kushte dhe mënyrë të përcaktuar me ligj të veçantë, nëse kompensimi i dëmit nuk mund të sigurohet nga i dënuari.

Të drejtat e veçanta për kategoritë e cënuara të viktimave⁴⁸:

(1) Viktimat e kanë të drejtën e masave të veçanta në mbrojtjen procesore gjatë dhënies së dëshmisë dhe hetimit në të gjitha fazat e procedurës:

1) nëse në kohën e dhënies së dëshmisë janë në moshë nën 18 vjet;

2) nëse me dhënien e dëshmisë ose përgjigjes në pyetje të caktuara, do ta ekspozojë vetveten ose personin e afërt në rrezik për jetën, shëndetin ose integritetin fizik (viktima të rrezikuara);

3) nëse për shkak të moshës, natyrës dhe pasojave të veprës penale, invaliditetit fizik ose psikik ose gjendjes tjetër shëndetësore me rëndësi, të kaluarës shoqërore dhe kulturore, rrethanave familjare, bindjeve fetare dhe përkatësisë etnike të viktimës, sjellja e të akuzuarit, anëtarëve të familjes ose miqve të të akuzuarit ndaj viktimës, do të ketë pasoja të dëmshme për shëndetin e tyre psikik ose fizik ose negativisht do të ndikojë mbi cilësinë e dëshmisë së dhënë (viktima veçanërisht të ndjeshme).

Masat e posaçme të mbrojtjes së procesit i përcakton gjykata me propozim të prokurorit publik ose viktimës ose me vlerësimin e vet kur është e nevojshme të mbrohen viktimat e rrezikuara dhe viktimat veçanërisht të ndjeshme.

Gjatë vendosjes për përcaktimin e masave të posaçme për mbrojtje të procesit nga paragrafi (2) të këtij neni, gjykata duhet ta marrë parasysh vullnetin e viktimës. Gjkata doemos duhet të përcaktojë masë të posaçme për mbrojtje të procesit në rastet nga paragrafi (1) pika 1) të këtij neni, si vijonë:

1) kur fëmija viktimë ka nevojë për përkujdesje dhe mbrojtje të veçantë ose

2) kur fëmija është viktimë e tregtisë me njerëz, dhunës ose abuzimit seksual.

⁴⁸ Neni 54 i LPP-së

Në rastet nga paragrafi (4) të këtij neni, gjykata doemos duhet të përcaktojë, veç e veç ose së bashku me masë tjetër të posaçme, video incizim ose incizim të zërit për dëshminë dhe hetimin e fëmijës që të përdoret si provë në procedurë.

Në raste ekskluzive, për shkak të rrethanave të reja të rastit, gjykata mund të urdhërojë që hetimi të përsëritet me fëmijën viktimë, por më së shumti edhe një herë edhe atë përmes shfrytëzimit të mjeteve teknike për komunikim.

Zbatimi i masave të posaçme për mbrojtjen e procesit të fëmijëve viktimë, është rregulluar me ligj të posaçëm.

Të drejtat e veçanta të viktimave të veprës penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor, njerëzisë dhe të drejtës ndërkombëtare⁴⁹.

Viktima e veprës penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor, njerëzisë dhe të drejtës ndërkombëtare, përpos të drejtave nga neni 53 të këtij ligji, i ka edhe këto të drejta:

- 1)** para hetimit të bisedojë me këshilltar pa pagesë ose me person të autorizuar, nëse në procedurë merr pjesë si i dëmtuar;
- 2)** të merret në pyetje nga personi i të njëjtës gjini në polici dhe në prokurorinë publike;
- 3)** të mos përgjigjet në pyetjet të cilat kanë të bëjnë me jetën personale të viktimës, ndërsa nuk janë të lidhura me veprën penale
- 4)** të kërkojë marrjen në pyetje me ndihmën e mjeteve vizuale - të zërit në mënyrën të përcaktuar me ligj dhe
- 5)** të kërkojë mënjanimin e publikut nga seanca kryesore.

Gjykata, prokuroria publike dhe policia janë të obliguara që ta këshillojnë viktimën për të drejtat e saj nga paragrafi (1) të këtij neni, më së voni para marrjes në pyetje për herë të parë për çfarë hartojnë shënim zyrtar ose procesverbal.

⁴⁹ Neni 55 i LPP-së

Definimi i konceptit viktimë dhe konceptit fëmijë-viktimë të dhunës ose veprës penale

Viktima e cila nuk është njoftuar për të drejtën e saj që në procedurë të marrë pjesë si e dëmtuar neni 56 i LPP-së.

(1) Viktima e cila nuk është e njoftuar për të drejtën e saj që të marrë pjesë në procedurën si e dëmtuar, ka të drejtë të paraqitet në polici ose prokurori publike si e dëmtuar deri në parashtrimin e aktakuzës, ndërsa para gjykatës deri në përfundim të seancës kryesore.

(2) Fletëparaqitja e viktimës si i dëmtuar do të refuzohet nëse është evidente se nuk është e arsyeshme ose se është parashtruar me vonesë.

Mosha nuk duhet të jetë pengesë për të drejtën e pjesëmarrjes së plotë të fëmijës në procedurë. Çdo fëmijë duhet të trajtohet si dëshmitar i aftë, ndërsa dëshmia e tij nuk duhet të vlerësohet si e pavlefshme vetëm për shkak se mosha e fëmijës, derisa mosha e tij/saj dhe pjekuria të mundësojë dhënie të dëshmisë së kuptueshme dhe të besueshme, me ose pa mjete ndihmëse të komunikimi dhe/ose ndihmë tjetër. Fëmijëve dhe dëshmitarëve duhet mbrojtur privatësia si çështje e rëndësisë primare. Duhet të ndërmerren masa për mbrojtje të identitetit të fëmijës nga publiku⁵⁰.

Koncepti “Drejtësi për fëmijë” i përfshin fëmijët, të cilët kanë ra ndesh me ligjin (gjegjësisht fëmijë, të cilat kanë qenë të regjistruar, akuzuar ose njohur si shkelës të kodit penal), fëmijë të cilët janë gjetur në rolin e viktimës ose dëshmitarëve të krimit, si dhe fëmijë në rrezik nga përfshirja në sistemin juridiko-penal (qoftë për shkak të gjendjes sociale ose për shkak se kanë bërë ndonjë vepër, e cila do të konsiderohej vepër penale, nëse fëmija do të ishte i moshës me përgjegjësi penale). Mund të thuhet se ky është koncept gjithëpërfshirës, i orientuar në favor të interesave më të mira të të gjithë fëmijëve, të cilët kanë rënë në kontakt me sistemin juridik dhe sistemet tjera relevante. Ai përfshin aspekte të ndryshme, siç është preventiva, diversioni, rehabilitimi, shërbimet për ofrim të ndihmës dhe mbështetja e masave të mbrojtjes. Koncepti drejtësi për fëmijë dallon nga termi “drejtësi për të mitur”, për shkak se nuk i përfshin vetëm fëmijët, të cilët kanë rënë ndesh me ligjin, por të gjithë fëmijët, që janë në

⁵⁰ Shih, procedurë për fëmijë, 2014

kontakt me ligjin, për shembull fëmijët viktimë dhe fëmijët dëshmitarë. Procedurat e procesit gjyqësor nëpër të cilat kalon fëmija, që ka rënë ndesh me ligjin janë dhënë më poshtë.

Parimi i interesit më të mirë të fëmijës

“Interesi më i mirë i fëmijës gjithnjë duhet të jetë parim që do tju drejtojë gjatë marrjes së vendimeve për fëmijët.

Çdo fëmijë ka të drejtë që interesat më të mira të tij të jenë me rëndësi primare në të gjitha vendimet, të cilat kanë të bëjnë me te, përfshirë edhe të drejtën e mbrojtjes nga çdo formë të përdhimit, abuzimit ose braktisjes.

Konventa për të drejtat e fëmijës në nenin 3 e proklamon këtë parim të interesave më të mira të fëmijës duke i dhënë rëndësi parimit qenësor, i cili duhet të implementohet në të gjitha dokumentet dhe instrumentet, të cilët kanë të bëjnë me fëmijët. Në këtë drejtim, të gjitha aktivitetet të cilët kanë të bëjnë me fëmijët, me rëndësi primare i kanë interesat e fëmijës, pavarësisht nëse ato i zbatojnë institucionet publike ose private për mbrojtje sociale, gjykatat dhe organet administrative.

Përfundimi

Me nocionin viktimë të veprës penale nënkuptohet çdo person, i cili ka pësuar dëm, përfshirë dëmtim fizik dhe mendor, vuajtje emocionale, humbje materiale ose dëmtim dhe kanosje tjetër të të drejtave dhe lirive themelore të tij si pasojë e kryerjes së veprës penale.

Me nocionin fëmijë viktimë të veprës penale nënkuptohet personi i mitur deri në 18 vjeç.

Me afrimin e Maqedonisë drejt Bashkimit Evropian, avancimi i të drejtave të shtresave fragile ku bëjnë pjesë edhe fëmijët është diçka e domosdoshme. Në këtë aspekt punohet intenzivisht dhe duhet thënë se janë bërë hapa të rëndësishëm përpara por gjithashtu ngelet edhe shumë punë për tu bërë për tu arritur niveli i dëshirueshëm i zbatimit të të drejtave nga shtresa të caktuara.

Problem, ngelet sensibilizimi i njerëzve për të drejtat që ju takojnë. Siç e cekta edhe më lartë, shoqëria jonë karakterizohet për faktin se është tepër konzervatore, diku-diku edhe me tipare të theksuara patriarkale dhe kjo e bën të vështirë zbatimin e të drejtave të fëmijëve. Dhe kur kjo gjendje faktike kombinohet me faktin se institucionet shtetërore nuk kanë kapacitete të nevojshme për tu kujdesur për implementimin e plotë të të drejtave të shtresave fragile, kjo e bën situatën akoma më të rëndë.

Ligji i ri për fëmijë precizon shumë qartë sferën e të drejtave të fëmijëve por në teren zbatimi është paksa i vështirë, për arsyet që i përmenda më lartë. Për këtë arsye është e nevojshme që përveç dispozitave ligjore, të bëhet e mundur ndërtimi i mekanizmave që do ta bënin të mundur zbatimin e ligjit në teren.

Zbatimi i masave të posaçme për mbrojtjen procesore të fëmijëve viktimë, është rregulluar me ligj të posaçëm.

Masat e posaçme të mbrojtjes procesore i përcakton gjykata me propozim të prokurorit publik ose viktimës ose me vlerësimin e vet, gjithnjë duke e marrë parasysh vullnetin e viktimës. Mirëpo, gjykata domosdo duhet të caktojë masë mbrojtje procesore për fëmijën viktimë, i cili

ka moshë nën 18 vjetë apo kur fëmija është viktimë e tregtisë me njerëz, dhunës ose abuzimit seksual. Me rastin e caktimit të masës mbrojtëse procedurale ndaj fëmijut viktimë, gjykata doemos duhet të përcaktojë video ose audio inxhizim për deklarin dhe marrjen në pyetje të fëmijës në mënyrë që inxhizimi të përdoret si provë në procedurë.

Biblografia-

Burime primare :

1. Ismail Zejneli - Delikuenca e të miturve në Republikën e Maqedonisë, Tetovë, 2018;
2. Ismet Salju - E drejta penale për të mitur, Prishtinë, 1998;
3. Vesel Latiifi - Kriminalistika e delikuencës së të miturve, Prishtinë, 1982;
4. P.Nushi - Faktorët që ndikojnë në të formuarit e sjelljeve të fëmijëve problematik“, Mihail Valter – Delikuenca e të miturve, Keln 2004;
5. Gordana Lazhetiq, Lazer Nanev, Olga Koshvaliska - Krivicno postapuvanje sprema decata vo rizik i vo sudir so zakon;
6. Gruda Zejnullah - Mbrojtja nderkombëtare e të drejtave të njeriut – Prishtinë 2007;
7. Doc-dr.Bashkim Selmani - E drejta e të drejtave të njeriut Universiteti parë Fon – Shkup, 2009;
8. Doc-dr.Bashkim Selmani - Të drejtat e njeriut në këndveshtrimin nderkombëtar – Universiteti parë Privat Fon Shkup 2006;
9. Michel Fromont - Sistemet e huaja më të mëdha të së drejtës perkthyen nga Edment Xhabija dhe Kleoparta Koleka Papyrus Tiranë 2009;
10. Mark W.Janis Richard S.Kai Richard bradedley W.Anthony E drejta Europiane e të drejtave të njeriut – Prishtinë 2002;
11. Vlado Kambovski, - Organiziren kriminalitet, Shtip 2005;
12. Bistra Netkova & tjerë - Human Right and domestic violence, Tetovë 2007;
13. Procedura për veprim me fëmijën viktimë - Unicef – 2014;
14. Koncept për përforcimin e këshillave komunale për parandalimin e delikuencës të të miturit, Kavadar 2012;
15. Julinda Cilingir - Niveli i Recidivizmit të të miturve në konflikt me ligjin në sistemin penitenciar, 2013, 2014 - Save dhe children;

Ligjet parlamentare:

1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë;
2. Nikola Tupaneski - Kodi i Republikës së Maqedonisë, 2017;
3. Zakon za pravda za decata – Sluzben vesnik br.148;
4. Prof.d-r.Gordana Kalajxhiev & Prof. d-r Gordana Laxhetiç Buzharovska
Ligji i Procedurës Penale Shkup, 2011;

Konventat ndërkombetare:

- Konventa për të drejtat e fëmijës;
- Konventa Europiane “Për marrëdhëniet me fëmijët;
- Konventa Europiane “Mbi ushtrimin e të drejtave të fëmijëve” ;
- Karta Sociale Europiane;